



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 30 regjistër (JR)
Datë 29.07.2024

Nr. 97 i vendimit
Datë 18.12.2025

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Ina Rama	Kryesuese
Rezarta Schuetz	Relatore
Mimoza Tasi	Anëtare
Albana Shtylla	Anëtare
Natasha Mulaj	Anëtare

- mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 18.12.2025, ditën e enjte, në orën 11:30, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Theo Jacobs, me Sekretare Gjyqësore Arjela Vllaçaj, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 30/2024 (JR), datë 29.07.2024, që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit Madrid Kullolli, prokuror pranë Prokurorisë së Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 758, datë 16.04.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Madrid Kullolli.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës; neni F i Aneksit të Kushtetutës; neni 42 dhe 1, 2, 62, 63 dhe 66, pika 1 germa “b” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe jurisprudenca e GjEDNj-së; ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar dhe Kodi i Procedurës Civile.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi shkaqet e ankimit dhe parashtrimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit, i cili kërkoi kalimin e çështjes në seancë gjyqësore publike, shqyrtimin në themel të fakteve dhe

provave, ndryshimin e vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) dhe konfirmimin e tij në detyrë, dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes Rezarta Schuetz, si dhe e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Madrid Kullolli (referuar në vijim si “subjekti” dhe ose “subjekti i rivlerësimit”) në momentin e hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese ushtronte detyrën e prokurorit në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Durrës. Për këtë arsye, ai iu nënshtroi rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.
2. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), Komisioni administroi deklaratat dhe formularët e dorëzuar nga subjekti dhe raportet e hartuara nga organet ndihmëse, deklaratën e pasurisë *vetting* dorëzuar pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), deklaratën për kontrollin e figurës pranë Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”)¹, si dhe formularin për vetëvlerësimin profesional pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë (në vijim “KLP”)², sipas së cilave:
 - 2.1. ILDKPKI-ja³, në zbatim të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, ka konstatuar se:
 - deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;
 - ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
 - nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
 - nuk ka kryer deklaram të rremë;
 - subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.
 - 2.2. DSIK-ja përcolli raportin e kontrollit të figurës së subjektin, nëpërmjet të cilit konkludoi përshtatshmërinë për vijimin e detyrës.
 - 2.3. KLP-ja dërgoi raportin e detajuar të kontrollit të aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

3. Me vendimin nr. 758, datë 16.04.2024, me shumicë votash⁴, Komisioni vendosi *shkarkimin* nga detyra të subjektit të rivlerësimit, bazuar në kriterin e kontrollit të pasurisë. Komisioni konkludoi se subjekti gjendet në kushtet e parashikuara nga neni 33, pika 5, gjerat “a” (sipas leximit *a contrario*) dhe “b” të ligjit nr. 84/2016, dhe duhet zbatuar neni 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, i cili

¹ Me shkresën e DSIK-së nr. {***} prot., datë 02.11.2017. DSIK-ja ka konstatuar përshtatshmërinë e subjektit për vazhdimin e detyrës.

² Raporti me nr. {***} prot., datë 28.09.2023, për vlerësimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit.

³ Raporti i ILDKPKI-së nr. {***} prot., datë 08.11.2019.

⁴ Komisioneri Lulëzim Hamitaj, doli me mendim pakice, kundër shkarkimit të subjektit të rivlerësimit.

e vendos atë në kushtet e një deklarimi të pamjaftueshëm, për zbatimin e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

III. Shkaqet dhe pretendimet në ankim

4. Me vendimin e mësipërm të Komisionit, nuk është dakord subjekti i rivlerësimit, i cili ka ushtruar ankim. Subjekti kundërshton konkluzionin e analizës financiare të Komisionit, si për pasaktësinë në deklarime, ashtu edhe për mungesën e burimeve të ligjshme. Subjekti ngre pretendime që lidhen edhe me procesin e rregullt ligjor, duke pretenduar se ky parim i është cenuar. Shkaqet e ankimit, në mënyrë të përmbledhur, paraqiten si vijon.

4.1. Për procesin e rregullt ligjor

(i) Subjekti pretendon se vendimi i Komisionit është arbitrar dhe rast i drejtësisë së mohuar. Atij i është shkelur e drejta për proces të rregullt ligjor, sipas nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në vijim “KEDNJ”) dhe nenit 42 të Kushtetutës, pasi duke mos respektuar analogjinë në raste të ngjashme të vendimmarrjes së Komisionit dhe Kolegjit të Posaçëm të Apelit (në vijim “Kolegji”), i është cenuar siguria juridike dhe nuk i është respektuar jeta private, sipas nenit 8 të KEDNJ-së. Subjekti pretendon se Komisioni nuk ka dhënë arsye, përse nuk përfshiu në analizë të ardhurat e vërtetuara, por të padeklaruara, si dhe faktin që është ndëshkuar për pasaktësitë në deklaratat periodike vjetore të pashoqëruara me pamjaftueshmëri.

(ii) Vendimi për shkarkimin nga detyra nuk mbështetet në pikën 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, pasi nuk është marrë bazuar në kriterin e kontrollit të figurës dhe atë të pasurisë, por vetëm në kriterin e kontrollit të pasurisë. Duke e kualifikuar subjektin të besueshëm në nivelin e kontrollit të figurës, ky vendim është i cenueshëm, i pabazuar në ligj dhe ndaj tij nuk mund të merret masa disiplinore e shkarkimit nga detyra. Masa disiplinore e shkarkimit nga detyra, për kriterin e kontrollit të pasurisë, është rasti i gjendjes në kushtet e deklarimit të më shumë se dyfishit të pasurisë së ligjshme, parashikuar nga pika 1 e nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

(iii) Mungesa e burimeve financiare të ligjshme mund të përbëjë deklarim të pamjaftueshëm në kuptim të pikës 3 të nenit 61, vetëm nëse është në atë nivel të rëndë shkelje të krahasueshëm ose të barabartë me fshehjen e pasurisë, deklarimin e rremë ose situatën e konfliktit të interesit.

4.2. Për kriterin e vlerësimit të pasurisë

(i) Për gjendjen *cash*, subjekti pretendon se ka njoftuar qëllimisht ILDKPKI-në për pasaktësitë në deklarim në vite dhe ka dhënë sqarime në procesverbalet përkatëse, duke dëshmuar vullnet për saktësim dhe transparencë.

(ii) Deklarata sqaruese e vitit 2010 ka vlerën e provës, njëjtë si deklaratat periodike. Në të ka shpjeguar për institucionet se ka kursyer gjendjen *cash* prej 3.200.000 lekësh. Sipas subjektit, gjendja *cash* e deklaruar si e mbetur në fund të vitit 2009 në vlerën 1.600.000 lekë, ishte informacion i gabuar i dhënë atij nga bashkëshortja. Kjo vlerë përfaqëson të ardhurat e familjes, që përfshinin edhe ato të prindërve të bashkëshortes, me të cilët jetoi.

(iii) Nga kontrolli aritmetik dhe logjik nuk ka kuptim që në vitin 2009 të rezultojë me balancë negative në shumën (-) 901.255 lekë, ndërsa në vitin 2010 të rezultojë me balancën pozitive (+) 2.177.765 lekë. Kjo balancë pozitive, sipas tij, është e pasaktë dhe nuk i përgjigjet situatës faktike. Gjendja *cash* prej 1.600.000 lekësh nuk u përdor asnjëherë si burim i krijimit të pasurive. Vlera *cash* e deklaruar në deklaratën sqaruese të vitit 2009 përbëhet nga të ardhura nga paga e subjektit dhe nga aktiviteti i bashkëshortes dhe është destinuar për shlyerjen pjesore të kredisë në Intesa San Paolo Bank.

(iv) Analiza financiare duhet të përfshijë të ardhurat dhe mundësinë e kursimit edhe të prindërve të bashkëshortes, pasi ata kishin mundësi të krijonin të ardhura të ligjshme, me të cilët subjekti ka jetuar rreth 10 vite.

4.3. Për burimet e krijimit të apartamentit në “{***}”, Tiranë

(i) *Depozita* e krijuar nga bashkëshortja në datën 03.12.2000 është ushqyer me të ardhurat e saj nga emigracioni në Greqi. Për këto të ardhura nuk kishte mundësi të provojë ligjshmërinë me dokumentacion dhe vlerat janë krijuar para martese [që u lidh në datën 13.12.2000]. Për pasojë, subjekti pretendon se nuk mund të ngarkohet me përgjegjësi. Ekzistenca e të ardhurave gjurmohet nga dokumentacioni bankar dhe mbështetet nga deklaratat e xhaxhait të bashkëshortes.

(ii) *Dhurata prej 3.000 eurosh nga i vëllai* -- Komisioni i ka rënduar pozitën duke mos i pranuar si të ligjshme të ardhurat e të vëllait nga emigracioni vetëm se nuk i deklaroi si burim pasurie në deklaratën e parë. Për pasurinë ka deklaruar si burim të ardhurat dhe kursimet familjare, duke menduar që shuma e dhuruar u destinua për përballimin e shpenzimeve të jetesës. Sipas subjektit, analiza e Komisionit se ka bërë deklarime kontradiktore është e pabazuar. Nga kontrolli rezultoi se vëllai i subjektit kishte mundësi të krijonte 2.000 euro në vitin 2001 dhe 1.000 euro në vitin 2002.

(iii) *Balanca negative* e periudhës 1998 – 2003 rrjedh nga mosmarrja në konsideratë e depozitave të krijuara nga bashkëshortja, dhurata nga i vëllai, si dhe llogaritja gabim e shpenzimeve të jetesës deri në vitin 1999. *Balanca negative*, e konstatuar për vitet 2003 dhe 2004, duhet të vlerësohet në zbatim të parimit të proporcionalitetit, me konsideratë faktin që kjo vlerë shpërndahet në disa vite edhe për faktin që në analizën 1999 – 2002 nuk janë përfshirë të ardhurat e bashkëshortes si asistente avokate, që i deklaroi në ILDKPKI në procesverbalin e datës 18.07.2016. Vlera (-) 560.563 lekë nuk mund të krijojë përgjegjësi disiplinore.

4.4. *Për njësinë* me sipërfaqe 40 m², në Tiranë, Komisioni padrejtësisht nuk ka përfshirë në analizë financiare: (i) të ardhurat e dhuruara nga vëllai; (ii) të ardhurat e bashkëshortes nga emigracioni, të depozituara në bankë; si dhe (iii) të ardhurat e bashkëshortes si asistente avokate gjatë periudhës mars – dhjetor 2000. Sipas subjektit, ai do të rezultonte me balancë pozitive në datën 12.12.2003, nëse të ardhurat e bashkëshortes përfshihen të plota *pa përlllogaritur* shpenzime jetese, për shkak se jetonte me prindërit.

4.5. Për të ardhurat nga shitja e automjetit tip “Mercedes Benz”

(i) Mospërfshirja në analizën e vitit 2009 e të ardhurave prej 4.800 eurosh nga shitja e këtij automjeti është e gabuar. Ruajtja e faturave të shpenzimeve të mirëmbajtjes, që i rritën vlerën e automjetit, nuk ishte detyrim ligjor.

(ii) Në deklaratën periodike të vitit 2005, deklaroi *burimin fundor* të krijimit të të ardhurave që shërbyen për blerjen e automjetit, të ardhurat nga paga. Gjatë vitit 2004 jetoi me prindërit e bashkëshortes dhe si burim i krijimit të kësaj pasurie shërbyen kursimet e tyre, të cilat i kanë kthyer brenda vitit 2005 e, për pasojë, nuk kishte detyrim deklarimi.

4.6. *Në lidhje me analizën financiare*, subjekti pretendon se:

(i) Analiza kumulative deri në vitin 2003 rezultoi me një balancë prej (-) 449.064 lekësh. Në vitin 2004, balanca negative prej (-) 127.966 lekësh rrjedh prej diferencës së kursit të këmbimit në monedhën dollarë të pagesës prej 16.000 USD. Balanca negative e vitit 2003 është për këstin 7.000 euro, të paguar për blerjen e apartamentit në {***}, Tiranë. Kjo balancë negative vjen për shkak se në analizën financiare nuk janë përfshirë të ardhurat e bashkëshortes si asistente avokate përgjatë periudhës 1999-2002. Pamundësia për shlyerjen e shumës 8.000 euro dhe përballimi i shpenzimeve të jetesës në vitin 2004 është krijuar për shkak të diferencës së kursit të këmbimit.

(ii) Diferenca negative prej (-) 901.205 lekësh e vitit 2009 nuk qëndron, pasi është rrjedhojë e përfshirjes së shumës prej 1.600.000 lekësh, që i përket kursimeve të prindërve të bashkëshortes. Bashkëshortja i dha informacion të gabuar në momentin e plotësimit të tabelës sqaruese. Kjo vlerë nuk u përdorur asnjëherë nga subjekti e personi i lidhur.

(iii) Balanca totale negative, që sipas subjektit është (-) 577.060 lekë, në kuadër të parimit të proporcionalitetit, nuk përbën shkak për marrjen e masës së shkarkimit nga detyra.

IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelit

A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit

a) *Juridiksioni i Kolegjit*

5. Bazuar në nenin 179/b, pikat 3, 4 dhe 5 të Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion lëndor [*ratione materiae*] për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, që kanë për objekt rivlerësimin e subjekteve të rivlerësimit, me përjashtim të vendimeve për pezullim dhe detyrim për trajnim një vjeçar⁵. Çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur shkarkimin atë nga detyra të subjektit të rivlerësimit Madrid Kullolli, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

b) *Mbi legjitimitimin e ankuesit*

6. Ankuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe të nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis*. Ankimi është depozituar pranë

⁵ Parashikuar nga neni E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës.

Komisionit, brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të këtij të fundit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

c) *Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit*

7. Në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimeve të subjekteve të rivlerësimit kundër vendimit të Komisionit, si rregull bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomën e këshillimit, përveç rasteve kur trupi gjykues vlerëson se plotësohen kriteret për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve, sipas nenit 51⁶ të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 49/2012”), thirrur për zbatim në mënyrë të drejtpërdrejtë nga neni 4 i ligjit. Në të kundërt, për sa kohë Kolegji nuk konstaton nevojën për të vërtetuar fakte të reja dhe marrë prova të reja për konstatimin e plotë dhe të saktë të gjendjes faktike apo shkelje të rënda procedurale, shqyrtimi bëhet mbi bazë aktesh në dhomë këshillimi. Subjekti ka kërkuar kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore publike.

d) *Parashtrimet e subjektit depozituar në Kolegj*

7.1. Në vijim të shpalljes së datës së caktimit të seancës gjyqësore, në datën 03.12.2025, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në Kolegj parashtrimet e tij me shkrim, si dhe disa akte bashkëlidhur⁷. Parashtrimet e subjektit kryesisht iu qëndrojnë pretendimeve në ankim dhe shpjegimet përqendrohen edhe rreth disa akteve të depozituara bashkëlidhur parashtrimeve. Trupi gjykues vëren se të gjitha aktet i janë nënshtruar hetimit dhe vlerësimit të Komisionit. Si të tilla, faktet që synohet të provohen do të bëhen pjesë e vlerësimit të Kolegjit nëpërmjet analizës së shkaqeve të ankimit, ndërsa marrja e tyre sërish si provë është e panevojshme.

7.2. Për sa i përket kërkesës së subjektit për ta shqyrtuar ankimin në seancë gjyqësore publike, trupi gjykues i Kolegjit vëren se nuk gjen zbatim asnjë prej rrethanave ligjore të nenit 51 të ligjit nr. 49/2012, që do të diktonte nevojën për një formë të ndryshme shqyrtimi. Konkretisht, sikurse rezulton edhe nga fakti që qoftë me ankimin e as me parashtrimet subjekti nuk ka përcjellë akte të reja, edhe në vlerësimin e kryer nga trupi gjykues kryesisht, nuk u identifikua nevojë për të çelur hetimin për të saktësuar situatën faktike. Po ashtu, trupi gjykues i Kolegjit nuk identifikoi shkelje procedurale, të cilat do të duhet të shëroheshin nëpërmjet kryerjes së seancën publike/në prani të subjektit të rivlerësimit. *Së fundmi*, nuk rezulton që gjatë hetimit administrativ provat u

⁶ I cili zbatohet nëpërmjet pikës 6 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016: “Kur është rasti, institucionet e rivlerësimit mund të zbatojnë edhe procedurat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative ose në ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, nëse këto procedura nuk janë parashikuar nga dispozitat e Kushtetutës ose të këtij ligji”.

⁷ Subjekti ka shoqëruar parashtrimet me aktet që vijojnë: **(i)** Kontratë noteriale të shitblerjes së banesës në datën 04.04.2006, nëpërmjet të cilës vjeherri krijoi të ardhura 2 milion lekë sipas deklaratës sqaruese të vitit 2009 të subjektit; **(ii)** Kontratën e shitjes së banesës së blerë fillimisht me prindërit e bashkëshortes; **(iii)** Vendim për regjistrimin e personit fizik në emër të bashkëshortes së subjektit – në të cilin referohet si vendbanim ai i prindërve të saj; **(iv)** Përgjigje FSHU dhe përgjigje UKD, për të provuar se subjekti jetonte tek vjehërria e tij në Lagjen nr. {***}, rruga “{***}” [më pas ndryshuar emri në rrugën “{***}”] Durrës. **(v)** Përgjigje e Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, nëpërmjet të cilës, referohet se babai i bashkëshortes së tij, që nga data 03.08.2006 ka banuar se bashku me familjen e subjektit; **(vi)** Deklaratat periodike vjetore të subjektit tregojnë adresë banimi atë të vjehërrisë.

administruar në kundërshtim me ligjin, në mënyrë që të nevojitet marrja e tyre sërish. Subjektit i është dhënë mundësia të japë shpjegime e paraqesë akte që i provojnë ato.

7.3. Hetimi administrativ i kryer nga Komisioni ka nisur që në janar 2021, ka përfunduar për herë të parë në mars 2024 e është riçelur e përfunduar në prill 2024. Subjektit i janë dërguar katër (4) pyetësorë dhe pasi ka marrë rezultatet e hetimit, ka dërguar edhe shpjegimet mbi barrën e provës. Sipas vendimit të Komisionit, nëpërmjet akteve dhe shpjegimeve, subjekti ka arritur të përmbysë barrën e provës për një numër të konsiderueshëm konstatimesh, si pasojë e të cilave balanca negative financiare, sipas rezultateve të hetimit, është reduktuar në më pak se 25% e asaj për të cilën subjektit i ka kaluar barra e provës -- nga (-) 12.702.941 lekë për të përballuar shpenzimet dhe kursimet, në vendim Komisioni ka konkluduar për një balancë negative të reduktuar ndjeshëm, në vlerën (-) 2.821.616 lekë në konkluzionin përfundimtar. Komisioni ka pranuar shpjegimet e subjektit, duke ndryshuar konstatimin fillestar për veprime *fiktive* të kryera nga ai për njërën prej pasurive, në emër të prindërve të bashkëshortes.

7.4. Për sa më lart, edhe nga verifikimi kryesisht i procedurës së ndjekur nga Komisioni, trupi gjykues i Kolegjit nuk konstaton të meta të cilat mund të korrigjoheshin në seancë publike, sikurse as nuk ka vend të argumentohet edhe cenim i të drejtave për proces të rregullt, në tërësi. Si rrjedhojë, edhe parë në këtë këndvështrim, në përputhje me nenin 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe nenin 49, pika 1 e ligjit nr. 49/2012, trupi gjykues vendosi të shqyrtojë ankimin kundër vendimit të Komisionit, mbi bazë dokumentesh në dhomë këshillimi.

B. Vlerësimi i pretendimeve dhe shkaqeve të ankimit që lidhen me themelin e çështjes

B.I. Pretendimet për procesin e rregullt ligjor

8. Subjekti pretendon se vendimi i Komisionit është “tepër” arbitrar dhe çështja e tij rast i drejtësisë së mohuar. Sipas subjektit, Komisioni nuk ka respektuar analogjinë e ndjekur në raste të ngjashme dhe i ka shkelur të drejtën për proces të rregullt ligjor, sipas neneve 6 dhe 8 të KEDNj-së dhe nenit 42 të Kushtetutës, duke cenuar sigurinë juridike dhe aspekte të jetës private.

8.1. Pasi analizoi aktet në fashikull dhe pretendimet e subjektit, nën dritën e dispozitave konventore e ligjore që gjejnë zbatim, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se procesi i kryer në Komision ka qenë në përputhje e duke respektuar garancitë e subjektit për proces të rregullt. Sikurse është elaboruar gjerësisht në mënyrë të përsëritur në jurisprudencën e Kolegjit dhe konfirmuar edhe nga kontrolli i kryer nga GjEDNj-ja nëpërmjet çështjes *kyç* të rivlerësimit, *Xhoxhaj kundër Shqipërisë*, masa disiplinore e shkarkimit parashikuar nga ligji shqiptar nuk është disproporcionale dhe as në shkelje të parimeve të nenit 8 të Konventës⁸. Në këtë linjë, vendimi i Komisionit, për shkarkimin e subjektit nga detyra, në kushtet që [subjekti] është vlerësuar *i pabesueshëm* në vlerësimin e kriterit të pasurisë, në kuptim të kërkesës së germës “a” të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, nuk mund të argumentohet si cenim i së drejtës për *jetë private* e garantuar nga neni 8 i KEDNj-së, pasi është rrjedhojë e zbatimit të ligjit.

⁸ Shih paragrafët 402 dhe 403 të vendimit të GjEDNj-së në çështjen *Xhoxhaj kundër Shqipërisë*.

8.2. *Së dyti*, dhe sërish pa përsëritur sa është arsyetuar në vendime të mëparshme, në përgjigje pretendimesh identike nga subjekte të tjerë rivlerësimi, trupi gjykues i Kolegjit rithekson që për kryerjen e procesit të rivlerësimit, subjekteve që vendosin t'i nënshtrohen këtij procesi *ex officio*, iu kufizohen pjesërisht disa të drejta që lidhen me respektimin e jetës private⁹, parashikuar shprehimisht nga neni A i Aneksit të Kushtetutës. Kjo normë kushtetuese i është nënshtruar qoftë kontrollit të përputhshmërisë me garancitë konventore e kushtetuese, por edhe zbërthimit të saj nëpërmjet jurisprudencës së GjEDNj-së¹⁰. Për rrjedhojë, në nivel parimor nuk gjen vend kontestimi për cenim të jetës private, në kuptim të nenit 8 të KEDNj-së, në hetimin e një pasurie të deklaruar në deklaratën *vetting* e që i nënshtrohet kontrollit për efekt të procesit.

8.3. Ndonëse është e vërtetë që subjekti nuk gjendet në kushtet e deklaramit të dyfishit të pasurisë së ligjshme, si një ndër situatat ligjore të parashikuara nga neni 61 i ligjit nr. 84/2016, për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, sikurse ai vetë pretendon, masa disiplinore për të është marrë bazuar në një pikë tjetër të së njëjtës dispozitë. Komisioni konstatoi se subjekti ka kryer deklaramit të pasaktë dhe ka mungesë burimesh të ligjshme për krijimin e pasurive, që përbëjnë shkak për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Nga kontrolli i vendimit, ashtu sikurse edhe i procedurës së ndjekur nga Komisioni për konstatimin e cenimit të këtij parimi, aplikuar në çështjen objekt shqyrtimi, sipas kuptimit të nenit 8 të KEDNj-së¹¹, masa disiplinore do të konsiderohej disproporcionale, nëse Komisioni do të kishte disponuar atë pas një balance negative relativisht të ulët apo për problematikë që në tërësi nuk mund t'i atribuohet e përkojë në kohë me ushtrimin e detyrës nga subjekti, e rrethana të tjera për të cilat do të duhet të vihej në pyetje panorama tërësore që rezultonte si kundërgargument me shkarkimin nga detyra. Nga analiza që kreu trupi gjykues i Kolegjit, sikurse shtjellohet në detaj në vijim, Komisioni ka qenë tejet favorizues dhe ka pranuar një sërë pretendimesh deklarative të subjektit. Për këto arsye, balanca negative përfundimtare, jo vetëm nuk përbën rëndim të situatës që rezulton nga analiza, por në thelb është varianti më i favorshëm e garantist i mundshëm për të. Për këto shkaqe, pretendimi për masë disproporcionale, parë edhe në këtë kontekst, është i pakuptimtë.

8.4. Trupi gjykues i Kolegjit konstatoi edhe që pretendimi i subjektit se Komisioni nuk ka përfshirë në mesin e burimeve të ardhurat e vërtetuara, por të padeklaruara apo që është ndëshkuar për pasaktësitë në deklaratat periodike vjetore, të pashoqëruara me pamjaftueshmëri, është vetëm pjesërisht i bazuar. *Së pari*, të ardhurat që nuk janë deklaruar si burime krijimi pasurish dhe as vërtetuar me dokumentacion nuk mund të përfshihen në mesin e burimeve të ligjshme për efekt të analizës financiare. Ky shkak ankimi gjen trajtim edhe konkretisht i analizuar në secilën pasuri.

⁹ “[1.] Me qëllim kryerjen e procesit të rivlerësimit, zbatimi i disa neneve të kësaj Kushtetute, veçanërisht i neneve që lidhen më të drejtën për respektimin e jetës private, si dhe nenet 36 dhe 37, dispozitat që lidhen me barrën e provës, nenet 128, 131, nënparagrafi “f”, 135, 138, 140, 145, paragrafi 1, 147/a, paragrafi 1, nënparagrafi “b”, 149/a, paragrafi 1, nënparagrafi “b”, kufizohen pjesërisht, sipas nenit 17 të Kushtetutës. [...]”.

¹⁰ Referuar Opinioni nr. CDL-AD (2016)036 të Komisionit të Venecias, vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 2/2017 dhe arsyetimit të GjEDNj-së në paragrafin 402 të vendimit Xhoxhaj kundër Shqipërisë.

¹¹ (1) Çdokush ka të drejtën e respektimit të jetës së tij private dhe familjare, banesës dhe korrespondencës së tij. (2) Autoriteti publik nuk mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte, përveçse në shkallën e parashikuar nga ligji dhe kur është e nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, shëndetit ose moralit ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të tjerëve.

Në këndvështrim parimor, organet e rivlerësimit nuk mund të përfshijnë në analizë të ardhura *hipotetike e deklarative*. Nën dritën e nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 30 të ligjit nr. 84/2016, ndër të tjera, në kontrollin e pasurive në rivlerësim të ardhurat e deklaruara e të cilat kalojnë testin e ligjshmërisë, për më tepër, përfshihen në mesin e burimeve financiare të disponuara për efekt të pasurive dhe shpenzimeve që rezultojnë. Nëse do të ndiqej logjika që potencion subjekti, duke përfshirë në analizë likuiditete të pa provuara dhe as deklaruara, procesi i rivlerësimit do të kushtëzohej tërësisht në të ardhura në nivel sasior tërësisht diskrecionar e sipas nevojës konkrete të subjekteve të rivlerësimit e, për pasojë, përjashtuar edhe teorikisht një proces të bazuar në kriteret objektive e të kontrollueshme.

8.5. Nga ana tjetër, Komisioni ka konstatuar pasaktësi në plotësimin e deklaratave periodike vjetore në dy raste, të cilët në paragrafët 5.15 dhe 6.28 të vendimit i ka vlerësuar si shkelje të ligjit nr. 9049/2003. Përkundër këtyre dy konstatimeve, pasaktësia sipas ligjit që normon procesin e rivlerësimit, bazuar në germen “a” të “nenit 33”¹² të ligjit nr. 84/2016, në përmbyllje të analizës së pasurive nga Komisioni, është konfirmuar vetëm për mosdeklarimin e të drejtave reale dhe pagesat e kryera për një apartament gjatë vitit 2008. Por Komisioni ka konstatuar edhe pasaktësi për gjendjen e *cash*-it në deklaratën *vetting*, referuar në paragrafin 2.25 si mospërmbushje e detyrimit për deklarim të saktë në deklaratën *vetting*, dhe cilësuar sipas gremës “a” të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016. Në këto kushte dhe për sa kohë konkluzioni objekt analize i Komisionit qëndron për një prej pasurive të deklaruara në deklaratën *vetting* – likuiditetet *cash* -- trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se konkluzioni i Komisionit nuk është i pabazuar. Në këtë linjë është edhe konkluzioni përfundimtar i vendimit të Komisionit, kur subjektit nuk është penalizuar për mosdeklarime në deklaratat periodike. Ky vlerësim iu nënshtroa gjithsesi analizës së trupit gjykues të Kolegjit, si pasojë e të cilës u konfirmua më së paku mungesa e burimeve të ligjshme dhe u arsyetuar edhe për mungesën e besueshmërisë së pretendimeve të subjektit për shkak të inkonsistencës së deklaratimeve të tij. Për rrjedhojë, konstatimet në këtë pikë janë bërë pjesë e arsyetimit të detajuar të Kolegjit për pasuritë në fjalë dhe kontestimet e subjektit konsiderohen të shteruara.

8.6. Trupi gjykues i Kolegjit thekson se është i pabazuar dhe i pakuptimtë pretendimi se Komisioni nuk zbatoi analogjinë, duke i cenuar subjektit *sigurinë juridike*. Siguria juridike parimisht prezumon natyrën përfundimtare të vendimeve gjyqësore, parashikueshmërinë dhe qartësinë e ligjeve, mosaplikimin prapaveprues të ligjit penal dhe *së fundmi*, që ligji/normativa nuk mund të jetë ekuivoke apo të lejojë diskrecion arbitrar të pakufizuar autoriteteve, ndërsa ligji duhet të informojë qytetarët për rrethanat në të cilat institucionet kanë të drejtë të veprojnë. Asnjë prej këtyre aspekteve nuk mund të argumentohet se gjen zbatim në rrethanat konkrete. Me fjalë të tjera, nuk duket se ka vend një këndvështrim analitik, sipas së cilit thirrret në zbatim parimi i sigurisë juridike të cenuar për subjektin meqenëse vendimi i Komisionit për të është i ndryshëm nga vendimet e marra për subjekte të tjera. Që subjekti të krijojë pritshmëri objektive e legjitime bazuar në trajtimet që mund t’i jenë bërë një rasti/subjekti tjetër është e palogjikshme në vetvete. Procesit i rivlerësimit të secilit subjekt paraqet rrethana faktike e ligjore të ndryshme, që i nënshtrohen hetimit të bazuar në pasuritë e deklaruara, aktet/provat e paraqitura dhe shpjegimet e dhëna që janë

¹² Riprodhim i shkrimit origjinal. Presumohet gabim material në formën e mosshkrimit të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

specifike për secilin rast. *Së dyti*, sikurse referuar më sipër, Komisioni ka qenë tejet favorizues për subjektin dhe analiza financiare mbi të cilën është bazuar konkluzioni përfundimtar përbën versionin më garantist/të favorshëm për të. *Së treti*, edhe shqyrtimi i këtij ankimi, në Kolegj, përbën një mjet ligjor nëpërmjet të cilit procesi kontrollohet edhe në drejtim të ruajtjes së disa parimeve për të cilat disponohet me masë disiplinore. Për sa më sipër, pretendimi i subjektit nuk qëndron.

8.7. Pretendimi që vendimi i Komisionit duhet të merrej bazuar në kriterin e pasurisë dhe atë të kontrollit të figurës është, po ashtu, i pabazuar dhe i pakuptimtë tashmë. *Së pari*, kontrolli i subjektit është kryer bazuar në të tri kriteret. Komisioni e ka vlerësuar subjektin pozitivisht në kriterin e kontrollit të figurës dhe atë profesional, ndërsa ka konkluduar për deklaram të pasaktë e të pamjaftueshëm në kriterin e kontrollit të pasurisë, me pasojë zbatimin e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra. *Së dyti*, ligji nr. 84/2016¹³ dikton që vendimi për konfirmim kërkon kalimin me sukses të të tri kriterëve, ndërsa vendimi i shkarkimit mund të merret edhe mbi bazën e një kriteri të vetëm. Ky parashikim ligjor, i zberthyer gjerësisht në vendime të Kolegjit gjatë gjithë procesit, në mënyrë të përsëritur, është konfirmuar se ka për bazë parimin mbi të cilin nëse një subjekt është i pabesueshëm në kriterin e kontrollit të pasurisë, kalimi me sukses i dy kriterëve të tjerë nuk mund të passjellë konfirmim në detyrë gjithsesi. Është kaq me rëndësi ky parim në rivlerësim sa që neni 59 i të njëjtit ligj parashikon që edhe kalimi me sukses i të tri kriterëve nuk nënkupton konfirmim në detyrë nëse një subjekt gjendet në kushtet e nenit 61 pika 5 [cenim të besimit të publikut]. E thënë ndryshe, kriteret janë kumulative për konfirmimin dhe autonome për masën disiplinore të shkarkimit.

8.8. Sa më sipër, është konfirmuar nga praktika e GjEDNj-së në çështjen kyç *Xhoxhaj kundër Shqipërisë*¹⁴. Ky parashikim është elaboruar në praktikë edhe nga jurisprudenca e Kolegjit¹⁵, ku është vendosur në mënyrë konsistente që marrja e vendimit bazuar vetëm në njërin kriter nuk përbën cenim të procesit të rregullt ligjor. Subjekti u njoh me provat dhe rezultatet e hetimit të Komisionit, iu përgjigj pyetësorëve, si dhe paraqiti shpjegimet në përmbushje të barrës së provës. Në përfundim të hetimit, për kriterin e kontrollit të pasurisë, Komisioni konkludoi se subjekti ka bërë deklaram të pasaktë e të pamjaftueshëm, shoqëruar me mungesë burimesh të ligjshme, sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, me pasojë masën disiplinore të shkarkimit nga detyra.

8.9. Kontrolli i vendimit të Komisionit dhe akteve në fashikuj nuk tregoi që për subjektin të jenë cenuar elemente të proporcionalitetit. Subjekti dhe personat e lidhur janë konstatuar në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për krijimin e pasurive dhe përballimin e shpenzimeve me të ardhura të ligjshme, duke u vendosur nën parashikimet e germës “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit

¹³ Neni 4 pika 2 parashikon që: “[2.] Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit. Vendimi merret bazuar në një ose disa prej kriterëve, në vlerësimin e përgjithshëm të tre kriterëve, ose në vlerësimin tërësor të procedurave.[...]” Neni 59 pika 1 e ligjit: “1. Konfirmimi në detyrë i jepet subjektit të rivlerësimit në rast se plotësohen së bashku kushtet e mëposhtme: a) kur arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë; b) kur arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës; c) kur arrin një nivel minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale. [...]”

¹⁴ [133.] Sipas nenit 4, pika 1, procesi i rivlerësimit kryhet mbi bazën e tri kriterëve: vlerësimi i pasurisë; kontrolli i figurës; dhe vlerësimi i aftësive profesionale. Neni 4, pika 2 parashikon se vendimi merret bazuar në “një ose disa prej kriterëve, në vlerësimin e përgjithshëm të tri kriterëve (ose në vlerësimin tërësor të procedurave)”.

¹⁵ Shih, ndër të tjerë, vendimet e Kolegjit (JR) nr. 3/2018, që i përket subjektit të rivlerësimit Fatos Lulo, paragrafi 17; dhe (JR) nr. 9/2023, që i përket subjektit të rivlerësimit Nure Dreni, paragrafi 15.8.

nr. 84/2016. Edhe pasi pranoi një sërë shpjegimesh të subjektit, si pasojë e të cilave analiza financiare pësoi përmirësime të konsiderueshme, Komisioni arriti, gjithsesi, në konkluzionin se balanca negative e subjektit për gjithë periudhën e rivlerësimit ishte në masën (-) 2.821.616 lekë, që konsiderohet si një vlerë që e përjashton zbatimin e parimit të proporcionalitetit të masës¹⁶. Në këto kushte, masa disiplinore e marrë për subjektin ka qenë rrjedhojë logjike e vlerësimit të kriterit të pasurisë në hetimin administrativ të kryer nga Komisioni. Për këto arsye, pretendimi për cenim të dispozitës së nenit 61 të ligjit nr. 84/2016 apo të parimeve të procesit të rregullt ligjor është i pabazuar.

8.10. Në përmbledhje të sa më lart, trupi gjykues i Kolegjit vëren se vendimi i Komisionit është marrë duke u zbatuar parimet e parashikuara nga Kushtetuta dhe Aneksi i Kushtetutës, ligji nr. 84/2016, si dhe Kodi i Procedurave Administrative, ku subjektit i janë garantuar të drejtat që parashikohen që një proces gjyqësor/administrativ të konsiderohet i rregullt dhe ligjor.

B.II. Vlerësimi i pretendimeve që lidhen me kriterin e pasurisë

9. Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pasi mori në shqyrtim shkaqet e ankimit dhe parashtrimet e subjektit të rivlerësimit, si dhe analizoi aktet në fashikujt e krijuar në Komision, vlerësoi se vendimi objekt kontrolli i Komisionit është marrë në zbatim të ligjit dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi. Ky konkluzion mban në konsideratë që edhe në versionin më garantist, që rezulton nga analiza përfundimtare e Komisionit, subjekti i rivlerësimit rezulton, gjithsesi, me mungesë burimesh të ligjshme në një vlerë që përjashton zbatimin e parimit të proporcionalitetit. Në këtë drejtim, trupi gjykues i Kolegjit vëren se shpjegimet kontradiktore të subjektit të rivlerësimit dhënë ndër vite, passjellin mungesë të besueshmërisë dhe paraqiten më tepër në funksion të situatave specifike, në të cilat ai është gjendur në kontrollin e pasurisë ndër vite¹⁷, sesa të jenë një pasqyrim i realitetit. Në vijim, paraqitet një analizë për secilin aspekt të marrë në konsideratë nga trupi gjykues i Kolegjit, për shkaqet e ankimit.

10. Likuiditetet jashtë sistemit bankar deklaruar në deklaratën vetting

10.1. Në deklaratën *vetting*, subjekti ka deklaruar kursime nga të ardhurat familjare – gjendje *cash* në banesë, më 25.01.2017, në shumën *1.300.000 lekë*. Në përfundim të hetimit administrativ, si dhe pasi pranoi pretendimet e subjektit për t'i konsideruar kursimet e deklaruara çdo vit si gjendje dhe jo shtesa të vitit, Komisioni konkludoi se subjekti i rivlerësimit ka pasaktësi në deklaram, duke u gjendur [në një lexim *a contrario*] në kushtet e germës “a” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016. Kjo pasaktësi nuk ka qenë me peshë, për sa i përket ligjshmërisë së burimeve dhe sipas Komisionit nuk ka qenë shkak autonom për marrjen e masës disiplinore për subjektin. Ky konkluzion bazohet kryesisht në *mospërputhjet* në deklarinimin e *gjendjes cash* të subjektit në deklaratat periodike dhe deklaratën *vetting*.

¹⁶ Shih, ndër të tjerë, vendimin e Kolegjit (JR) nr. 1/2023, paragrafi 17.4., që i përket subjektit të rivlerësimit Andi Civici; vendimin e Kolegjit (JR) nr. 9/2023, që i përket subjektit të rivlerësimit Nure Dreni, paragrafi 15.9.

¹⁷ Subjekti rezulton të jetë pyetur e dhënë shpjegime pranë ILDKPKI-së rreth gjashtë (6) herë për problematika të ndryshme.

10.2. Subjekti ankimon konkluzionin e sipër referuar, duke kontestuar përgjithësisht mënyrën sesi Komisioni ka arsyetuar për këtë aspekt të kontrollit të pasurisë. Me ankimin, ai ka përcjellë një analizë financiare të hartuar nga një ekspert kontabël, nëpërmjet të cilës kundërshton mënyrën e përlllogaritjes së Komisionit. Ai argumenton se ka paraqitur sqarime të detajuara në ILDKPKI, për pasaktësitë në deklarin e gjendjeve *cash* në vite dhe ka dhënë sqarime në procesverbale, duke dëshmuar vullnet për saktësim dhe transparencë. Vlera prej 1.600.000 lekësh nuk duhet të përfshihej në analizën e tij për vitin 2009, pasi nuk përfaqëson të ardhura të tij, por të prindërve të bashkëshortes. Kjo ishte një vlerë e dhënë gabim nga bashkëshortja dhe zotëruesit kishin mundësi ta krijonin me të ardhura të ligjshme [*pasi shitën një apartament në vitin 2006 në vlerën 2.000.000 lekë*]. Sipas pretendimeve të tij, analiza financiare duhet të përfshijë edhe të ardhurat dhe kursimet e prindërve të bashkëshortes, me të cilët jetoi rreth 10 vite.

10.3. Nga analiza e akteve në fashikull dhe pretendimeve të subjektit, nën dritën e dispozitave ligjore që gjejnë zbatim, trupi gjykues i Kolegjit vëren se shpjegimeve të subjektit u mungon *besueshmëria*. Krahasimi i deklarinave të subjektit në deklaratat periodike, deklaratën *vetting*, shpjegimet në rezultatet e hetimit e në ankim, krahasuar me parashtrimet në Kolegji, tregon se subjekti ka paraqitur versione të *ndryshme* të gjendjes *cash* ndër vite nga deklaratat e kohës dhe në rezultatet e hetimit, që veç të tjerash, tregojnë kontradikta që edhe pamundësojnë kontrollin e mundësisë së krijimit të pasurive të deklaruara. Në këtë vlerësim, trupi gjykues i Kolegjit mbajti në konsideratë sa vijon.

(i) Pretendimet e subjektit se vlera prej 1.600.000 lekësh, e deklaruar gjendje në fund të vitit 2009, përbën kursime të prindërve të bashkëshortes, u vlerësuan jobindës edhe në Kolegji. Përpos momentit në kohë kur u ngrit ky pretendim për herë të parë – në një fazë të avancuar të hetimit administrativ, pasi subjekti u njoh me balancën negative të rezultateve të hetimit – ai bie ndesh me të gjithë dokumentacionin e kohës, përfshirë deklaratat periodike vjetore apo edhe sqarimet e dhëna nga subjekti për më së paku gjashtë (6) herë në zbatim të ligjit nr. 9049/2003 përpara procesit të rivlerësimit, sikurse edhe me shpjegimet e tij deri në njohjen me rezultatet e hetimit administrativ.

(ii) Pretendimet e ndryshuara të subjektit në vazhdimësi, sikurse rezulton nga aktet në fashikull, përfshirë edhe ato për të ardhurat e kursyera në *cash* ndër vite, nuk mund të passjellin ndryshimin e vendimit të Komisionit, qoftë për shkak të kundërthënive të qenësishme, por edhe sepse janë të pabazuara në ligj e bien ndesh në vetvete me shpjegimet e tij në kohë të ndryshme. Kolegji ka arsyetuar gjerësisht në jurisprudencën e tij¹⁸ se deklarimi koherent/në përputhje me udhëzimet e formularëve përkatës në deklaratat periodike vjetore për gjendjen *cash* jashtë sistemit bankar, merr rëndësi të veçantë në procesin e rivlerësimit, si *mënyra* e vetme e të provuarit të ekzistencës së këtij zëri pasuror.

(iii) Komisioni i ka dhënë vlerë të plotë provuese deklaratës sqaruese të subjektit të dorëzuar në ILDKPKI në një kohë të prezumuar në vitin 2010. Pavarësisht nga ky qëndrim apo edhe pranimit të deklarinave të subjektit gjatë hetimit administrativ për mënyrën e interpretimit të kursimeve në

¹⁸ Shih, ndër të tjerë, vendimet e Kolegjit në çështjet që i përkasin subjekteve të rivlerësimit E. Sadiku (JR) nr. 7/2019, E. Islamaj (JR) nr. 11/2019, G. Osmani (JR) nr. 20/2019, D. Peka (JR) nr. 27/2020.

vitet në vijim, dhe ndryshe nga mënyra sesi ai është shprehur qartazi, duke konsideruar shprehjen *shtesa si gjendje*, ka përmirësuar analizën financiare e *favorizuar* subjektin. Subjekti sërish rezultoi me mungesë burimesh edhe në analizën e krijuar në Komision, në cilindo version të mundshëm.

10.4. Nën dritën e garancive procedurale me ankimin, në përmbledhje të sa më sipër, nga kontrolli i analizës financiare dhe vlerësimeve ligjore të kryera nga Komisioni, në Kolegj konfirmohet *më së paku* balanca negative e konstatuar në Komision për vitin 2009, në masën (-) 901.205 lekë, që e vendos subjektin në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme, sipas germës “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016. Arsyetimi i Kolegjit, për secilin prej këtyre aspekteve, gjen pasqyrim në vijim.

10.5. Konkluzioni i Komisionit bazohet kryesisht në konstatimin e *mospërputhjeve* të konsiderueshme në deklaratimet e subjektit ndër vite, në deklaratën *vetting* dhe gjatë hetimit administrativ, për sa i përket likuiditeteve jashtë sistemit bankar dhe pamundësisë së subjektit dhe personit të lidhur për të mbuluar me burime të ligjshme shumën prej 1.600.000 lekësh të deklaruar prej tij në “deklaratën sqaruese”, pa datë dhe pa numër protokolli, që gjendet e depozituar e pjesë e dosjes së tij në ILDKPKI. Subjekti nuk ka provuar që kjo shumë u përket prindërve të bashkëshortes. Konkretisht, gjatë periudhës 2003-2009, subjekti nuk ka deklaruar kursime *cash* në deklaratat periodike vjetore. Në aktin e titulluar prej tij ‘Deklaratë Sqaruese’, subjekti ka pretenduar se gjatë kësaj periudhe kishte të kursyera shumën 3.200.000 lekë. Komisioni ka konstatuar, gjithashtu, se subjekti është jokonsistent edhe për çfarë përfaqësonin shumat e likuiditeteve në *cash* ndër vite, *gjendje* apo *shtesa*. Gjatë harkut kohor 2010-2015, subjekti ka deklaruar *shtesa cash*, ndërsa gjatë hetimit dhe në parashtrimet në Komision ka pretenduar se kanë qenë *gjendje* dhe jo *shtesa*.

10.6. Konkluzioni i mësipërm është rezultat i analizës së akteve të depozituara nga subjekti në ILDKPKI dhe jo pyetjeve të drejtuara atij nëpër pyetësorë për *cash-in*. Komisioni ka kërkuar dhe, për pasojë, administruar aktet që dispononte ILDKPKI-ja, përfshirë procesverbalet e mbajtura në vite dhe çdo dokumentacion të depozituar nga subjekti. Në këtë dosje, përveç deklarimeve periodike vjetore deri në vitin 2023, gjenden edhe dy akte të titulluara “*Deklarata Sqaruese*”, sikurse edhe aktet e gjeneruara gjatë dy kontrolleve nga ILDKPKI-ja, në dhjetor 2012 dhe korrik 2016. Nga deklarata sqaruese – prezumuar e hartuar gjatë vitit 2010¹⁹, sipas subjektit -- pas dorëzimit të deklaratës për vitin 2009, subjekti shprehet se ka konstatuar se duhet të *saktësojë* edhe vlerën e gjendjes *cash* të likuiditeteve, *pasi* është konsultuar me ILDKPKI-në për deklaratën për vitin 2009. Në përmbajtjen e kësaj shkrese, subjekti ka referuar likuiditete *cash* në totalin prej 3.200.000 lekësh, nga të ardhurat e tij dhe të bashkëshortes nga puna për periudhën *deri në vitin 2009*. Këto kursime, vijon deklarata, janë përdorur pjesërisht për shlyerjen e një kredie në vitin 2009. Në një tabelë të detajuar, subjekti ka paraqitur të ardhurat e tij dhe bashkëshortes, si dhe shpenzime familjare nga viti 1998 deri në vitin 2009, përfshirë pagesat e kredive dhe blerjen e pasurive. Subjekti ka pasqyruar në tabelë edhe një gjendje *cash* prej 2.600.000 lekësh në fund të

¹⁹ Për të cilën ILDKPKI-ja ka konfirmuar se është e pamundur të identifikohet data e saktë të dorëzimit.

vitit 2003 [me shifra dhe fjalë] dhe më 31.12.2009 ka pasur *cash* prej 1.600.000 lekësh [me shifra dhe me fjalë]²⁰.

10.7. Në një deklaratë sqaruese të *dytë*, që mban datën 26.03.2012, subjekti shprehet se në vitin 2010 është kontrolluar [nga ILDKPKI-ja] për deklarimin e vitit 2009 dhe për shkak të neglizhencës nuk ka deklaruar pakësimin e 10.000 eurove kursime në *cash*, as në deklaratën për vitin 2008. Këtë shumë, sipas subjektit, bashkëshortja e ka paguar për një garsonierë.

10.8. Me rezultatet e hetimit, Komisioni i ka kaluar subjektit barrën e provës për një balancë totale negative për kursimet në *cash* në shumën (-) 6.888.444 lekë. Kjo balancë përftohet kryesisht për shkak të *mospërfshirjes* së dy shumave të padeklaruara në deklaratat periodike në mesin e burimeve të ligjshme të disponuara, shumës 2.600.000 lekë në vitin 2003 dhe 3.200.000 lekë të deklaruar si kursime *cash* deri në vitin 2009. Po ashtu, shumën 1.600.000 lekë të deklaruar për vitin 2009, Komisioni ia ka ngarkuar ekonomisë familjare të subjektit. Për vitet 2010-2016, Komisioni ka përfshirë në analizën financiare shumat e deklaruar *shtesa* në përputhje me deklarimin dhe me dispozitat e ligjit nr. 9049/2003 dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

10.9. Nga ana tjetër, në vendim përfundimtar, Komisioni ka zeruar balancën negative për periudhën 2010-2016, duke pranuar thujtë të gjitha interpretimet e shpjegimet e subjektit. Komisioni pranoi ekzistencën e shumës 3.200.000 lekë si kursim për periudhën 2005-2008, duke potencuar *qëndrueshmërinë* e deklarimeve të subjektit në deklaratimet sqaruese dhe në vijim deri në parashtrime. U gjetën bindëse edhe sqarimet për shpërndarjen e kësaj shume ndër vite, duke reflektuar/korrigjuar, në analizën financiare, shumat e paraqitura nga subjekti në prapësime. *Së fundmi*, përkundër konstatimit bazuar në ligjin nr. 9049/2003 dhe kuptimin e fjalëve të përdorura në deklaratat e subjektit, në vendim, Komisioni zgjodhi të pranonte interpretimin e subjektit se shumat *cash* të deklaruar për periudhën 2010-2015, të cilat titullohen si *shtesa vjetore*, në fakt përfaqësojnë *gjendjen* në fund të vitit. Në përfundim të analizës financiare pas prapësimeve, Komisioni ka paraqitur një balancë negative për vitin 2009²¹ në shumën (-) 901.225 lekë.

10.10. Komisioni konkludoi se *nuk u gjet bindës* pretendimi i subjektit se *kursimet* në vlerën 1.600.000 lekë, të deklaruar në deklaratën sqaruese si *gjendje* në fund të vitit 2009, ishin nga kursimet e prindërve të bashkëshortes dhe ia ngarkoi këtë vlerë analizës financiare të subjektit në vitin përkatës. Komisioni evidentoi se: (i) as në deklaratën sqaruese dhe as në tabelën përmbledhëse shoqëruese nuk evidentohen deklarime për të ardhurat e prindërve të bashkëshortes për të justifikuar deklarimin e subjektit; dhe (ii) për sa kohë e pranoi si provë deklaratën sqaruese bashkëlidhur deklaratës periodike vjetore të vitit 2009, informacioni në përmbajtjen e saj [deklaratës] duhet pranuar në tërësi e jo në mënyrë të përzgjedhur²². *Së fundmi*, për mospërputhjen mes *gjendjes cash* të deklaruar në deklaratën *vetting* – në 25 janar 2017 [në vlerën 1.300.000 lekë] -- me atë të deklaruar në deklaratën periodike për vitin 2016 në mars 2017 [1.000.000 lekë], Komisioni pranoi kërkesën e subjektit dhe përfshiu në analizën kundrejt mjaftueshmërisë së

²⁰ Subjekti shprehet literalisht “aktualisht, kam *gjendje* në 31.12.2009 *gjendjen cash* 1.600.000 lekë (një milion e gjashtëqind mijë lekë)” [karakteret dhe germat siç i ka shkruar subjekti].

²¹ Kjo është një balancë që lidhet drejtpërdrejt me mundësinë e krijimit të deklaratimit e shumave *cash* në analizë.

²² Paragrafi 2.22, faqe 25 e vendimit të Komisionit:

<https://kpk.al/wp-content/uploads/2024/06/VENDIM-M.-KULLOLLI-anonimizuar.pdf>

krijimit të kësaj shume tërheqjet e bashkëshortes nga arka e zyrës së avokatisë. Komisioni shprehet se shpjegimi i subjektit është bindës dhe u pranua mundësia e krijimit të shumës 300.000 lekë gjatë periudhës 01.01.2017 – 25.01.2017.

10.11. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se pretendimi i subjektit se Komisioni ka gabuar në konstatimin se ai ka kryer deklarime të pasakta të gjendjes së *cash*-it është i pakuptimtë në kontekstin e parashtruar. Komisioni është mbështetur në një version, i cili është tejet favorizues për subjektin, që është pasojë, ndër të tjera, edhe e interpretimit alternativ e të pabazuar/deformues të koncepteve bazike logjike e gjuhësore, sikurse shprehjet *gjendje* kundrejt *shtesë*. Këto dy koncepte nënkuptojnë përkatësisht sasinë e parave *ekzistuese* në një moment të caktuar kundrejt sasisë që *i shtohet* një gjendjeje ekzistuese²³.

10.12. Duke pranuar pretendimet e subjektit që bien ndesh literalisht me mënyrën sesi ai ka deklaruar në deklaratat periodike vjetore për *cash*-in jashtë sistemit bankar të kursyer, Komisioni ka zeruar balancën negative që do të përftohej për kursimet e shpenzimet e viteve 2010-2015. Konkretisht, duke filluar nga viti 2010 e deri në deklaratën për vitin 2015, subjekti ka deklaruar kursime në *cash*, në rubrikën përkatëse të formularit dedikuar shtesave e pakësimeve. Subjekti është shprehur me fjalët: *e cila iu shtohet kursimeve familjare* [për vitin 2010] dhe për pesë vitet në vijim *e cila iu shtohet kursimeve familjare të deklaruara në vitet paraardhëse*. Paraqet rëndësi edhe fakti që subjekti nuk ka deklaruar pakësime, në asnjë nga këto deklarata, përfshirë edhe ato të hartuara pas “deklaratave sqaruese”, që logjikisht duhet të kishin shërbyer për të korrigjuar veprimet në vijim, në të njëjtën kohë që pretendohet se përbëjnë korrigjim të mënyrës së deklarimeve përpara vitit 2010 e deri në vitin 2011.

10.13. Po ashtu, trupi gjykues i Kolegjit vëren se ndonëse në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI në vitin 2016 subjekti ka potencuar dijeni të paplota, në fakt deklaratat e tij të viteve 2010 e pas sugjerojnë të kundërtën. Sikurse cituar edhe më sipër, subjekti deklaroi me detaje të plota dhe koherente e në përputhje me kërkesën e ligjit për të saktësuar kursimet gjatë vitit. E thënë ndryshe, pretendimet e subjektit në momente të caktuara në kohë, që kanë për bosht padijeninë pavarësisht nga shkaqet apo mungesën e njohurive, nuk mbështeten nga aktet e hartuara nën përgjegjësi prej atij vetë. Ato tregojnë një qasje që i përshtatet nevojës së momentit dhe jo domosdoshmërisht pasqyrim i realitetit.

10.14. Në vijim të sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit konstaton edhe që nga fashikulli i përcjellë nga ILDKPKI-ja rezultojnë dy kontrole: në dhjetor 2012 dhe korrik 2016. Nuk ka akte që të konfirmojnë pretendimin e subjektit për një kontroll në vitin 2010. Gjatë kontrollit të vitit 2012, rezulton se ILDKPKI-ja i ka kërkuar subjektit sqarime për deklaratimet *deri* në vitin 2011. Në këtë fashikull nuk ka referencë në të dhëna apo fakte që do të përkonin me deklaratat sqaruese të vitit 2010 dhe 2012. Kontrolli i ushtruar në vitin 2016 përfshin gjithë periudhën e deklarimit. Në kuadër

²³ Sipas fjalorit të gjuhës shqipe në <http://www.fjalori.shkenca.org/>:-- “*gjendje*” është “[11.] *fin. Sasia e të hollave që janë në një arkë; sasia e mallrave, e prodhimeve ose e lëndëve të para që janë në një ndërmarrje a në një vend në një kohë të caktuar. Gjendja e arkës. Gjendje fizike. Ka gjendje. Mban gjendje.*” *Krahaso me “shtesë”*: “[2.] *Pjesë që i shtohet diçkaje dhe e rrit a e plotëson sipërfaqen, vëllimin a sasinë e saj (pjesa që i shtohet një ndërtesë, një veshjeje për ta zgjatur a për ta zgjeruar, një sasië sendesh, një shumë të hollash, një numri njerëzish etj.); zmadhim, zgjerim, rritje. Shtesë e re (e madhe, e vogël, e rëndësishme). Shtesa natyrore e popullsisë. Shtesa mujore në peshë. Shtesa vjetore e prodhimit. [...] Shtesë fondesh. Shtesë rroge (mbi pagën). Shtesë për vjetërsi në punë. [...]”*

të këtij kontrolli, në procesverbalin e datës 18.07.2016, subjekti ka referuar deklaratat sqaruese dhe është shprehur se ka pasur njohuri “të kufizuara” për shumat *cash* të kursyera në vite dhe është shprehur se në fund të vitit 2014, gjendja e *cash*-it ka qenë 3.250.000 lekë, ndërsa pas vitit 2009 shumat *cash* të deklaruara në deklaratat periodike vjetore përfaqësojnë *gjendjen cash* të mbajtur në banesë dhe *jo shtesa* të vitit. Subjekti ka theksuar në mënyrë të përsëritur se këto shuma kanë pasur si burim të ardhurat personale dhe ato të bashkëshortes. Ky pretendim bie ndesh me shpjegimin pas rezultateve të hetimit se shuma prej 1.600.000 lekësh e deklaruar si e disponuar në fundvitin 2009, ishte në fakt e krijuar nga vjehërria e tij apo se e ka informuar gabim bashkëshortja.

10.15. Për më tepër, dhe duke iu rikthyer analizës përse qëndrimi i Komisionit është versioni më i favorshëm i mundshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë për subjektin, trupi gjykues i Kolegjit thekson se në kushtet që subjekti është shprehur qartë/pa asnjë ekuivok që kursimet e vitit në vlerat respektive *i janë shtuar atyre të deklaruara më parë*, në deklaratat periodike vjetore – akte të cilat hartohen nën përgjegjësinë e ligjit – dhe ai si prokuror që prej vitit 1998 ka për detyrë interpretimin e ligjit -- kërkimi i parashtruar pas njohjes me rezultatet e hetimit, për t’ia atribuar edhe këtë shumë vjehërrisë së tij, është i pabazuar. E thënë ndryshe, pretendimet rishtazi të subjektit për t’ia atribuar edhe këtë shumë parash prindërve të bashkëshortes, të cilët në vazhdimësi paraqiten si *përfitues*, ndonëse subjekti e bashkëshortja bashkërisht deklarojnë gjendje financiare shumë pozitive²⁴, u vlerësuan të pabazuara dhe me mungesa të spikatur besueshmërie, edhe nga trupi gjykues i Kolegjit. Arsyetimi i Komisionit për këtë zë është i bazuar.

10.16. Nga ana tjetër, si *obiter dictum*, trajektorja e arsyetimit të Komisionit për aspekte të tjera ka qenë pjesërisht e paqartë -- sikurse analizuar më sipër lidhur me problematikën e moskonsiderimit si prova të deklaratave periodike vjetore lexuar në harmoni me deklaratat sqaruese e pohimet e subjektit në ILDKPKI. Si pasojë e kësaj qasjeje jolineare, analiza përfundimtare në Komision është kryer tërësisht bazuar në pretendimet deklarative dhe retroaktive të subjektit në korrik 2016, gjatë kohës kur kuadri ligjor i rivlerësimit ishte në procesin përfundimtar legjislativ²⁵. Në këtë linjë, një analizë objektive, e bazuar në ligj dhe në aktet nënligjore dhe në jurisprudencën e Kolegjit, balanca negative e kursimeve do të gjente zbatim për gjashtë (6) vite dhe do të ishte në një vlerë shumë më të thellë sesa (-) 901.105 lekë²⁶. Për shkak të garancive procedurale me ankimin, trupi gjykues

²⁴ Komisioni ka pranuar një sërë pretendimesh të subjektit si pasojë e të cilave ai mbetet në kahun përfitues në raport më prindërit e bashkëshortes, ndonëse kjo e fundit ka qenë avokate e mirëpaguar -- ka deklaruar në deklaratën vetting të ardhura prej 16.381.160 lekësh për vitet 2005-2013 dhe 8.585.199 lekësh për vitet 2014-2016 dhe janë pronarë të disa pasurive të paluajitshme në Tiranë dhe në Durrës. Ndër përfitimet që tregojnë dinamikë të zbalancuar janë shitja e pjesës takuese të apartamentit në Durrës prindërve të bashkëshortes me çmimin e tregut, ndonëse blerja ishte 42% nën këtë vlerë. Nga kjo shitje, subjekti e bashkëshortja kanë gjeneruar 200% fitim *cash* të deklaruar në vitin 2014. Konkretisht, apartamenti që sipas çmimeve të referencës përlllogaritej 8.558.692 lekë në vitin 2006, është blerë nga subjekti e bashkëshortja [dhe prindërit e saj] 5.000.000 lekë [1/2 pjesë takuese 2.5 milionë lekë shpenzuar nga subjekti e bashkëshortja], shitur prindërve të saj për 5.200.000 lekë (afërsisht) në vitin 2014. Subjekti e ka shitur pjesën takuese me një fitim prej 2.700.000 lekë. Referencë, analiza e vendimit të Komisionit paragrafi 13 dhe nënpjesët e tij.

²⁵ Ligji nr. 84/2016 është miratuar në datën 30.08.2016, ndërsa ndryshimet kushtetuese janë sjellë me ndryshimet e ligjit nr. 76/2016, datë 22.07.2016.

²⁶ Nëse analiza do të kryhej në përputhje me deklaratat e subjektit ndër vite, kombinuar me “deklaratat sqaruese” të tij për shuma të caktuara në momente të caktuara, subjekti do të rezultonte me një balancë negative prej (-) 8.918.000 lekësh, përfutur si shumatore e mungesave të burimeve dhe balancave negative prej (-) 4.101.225 lekësh në vitin 2009, (-) 1.200.000 lekë (rrumbullakosur) në vitin 2011, (-) 1.300.000 lekë (rrumbullakosur) në vitin 2012, (-) 90.000 lekë (rrumbullakosur) në vitin 2013, (-) 1.525.512 lekë në vitin 2014, dhe (-) 704.370 lekë në vitin 2015. Në këtë total nuk

konfirmon minimalisht këtë balancë duke theksuar edhe që ajo mbetet pavarësisht se Komisioni praktikisht ka pranuar të gjitha pretendimet për interpretime alternative të kuptimit të drejtpërdrejtë gramatikor të deklarimeve të tij.

10.17. Kontradiktat e shumta e të përsëritura në deklarinimin e likuiditeteve [përpos aspekteve të tjera] dhe deklaratat sqaruese e vitit 2010 – duhet të jetë pasojë e faktit që në vitin 2003, në deklaratën e parë, subjekti ka referuar disa pasuri të atribuara kursimeve familjare. Konkretisht: (1) apartament me sipërfaqe 70 m², me vlerë 2.600.000 lekë, në Tiranë [në {***}]; (2) truall me sipërfaqe 243 m², në Sarandë; (3) depozita bankare 2.470 USD dhe, më tej, në deklaratën periodike të vitit 2004, subjekti deklaroi; (4) kontratën e sipërmarrjes për zyrën me sipërfaqe 40 m², për të cilën deklaroi se në vitin 2003 shleu vlerën 36.000 USD, me burim të ardhurat personale. Viti 2003 përkon me shpenzime të konsiderueshme për subjektin, fakt që shpjegon edhe pretendimin në “Deklaratën sqaruese” pa datë se deri në vitin 2003 kurseu 2.600.000 lekë²⁷. Subjekti ka kërkuar që kjo deklaratë, së bashku me deklaratat e tjera me të cilat është përpjekur të shërojë pasaktësitë e deklarimeve ndër vite, të marrë vlerë të plotë provuese në procesin e rivlerësimit. Nga ana tjetër, dhe pavarësisht nga ky kërkim, të cilin Komisioni e ka pranuar, pasi u njoh me balancën negative me rezultatin e hetimeve dhe në ankim subjekti kërkon që deklaratës sqaruese t’i pranohen ndryshime të reja prapavepruese, duke përfshirë/ricilësuar vlerën 1.600.000 lekë si gjendje financiare e vjehërisë së tij.

10.18. Në deklaratën sqaruese, subjekti nuk ka shpjeguar si varioi gjendja e tij *cash* në banesë në secilin vit, por e ka pasqyruar atë në total. Pasi në rezultatet e hetimit administrativ, Komisioni i bëri me dije subjektit pamundësinë e krijimit të shumës 2.600.000 lekë me burime të ligjshme në harkun kohor 1998-2003 – referuar shpjegimit në deklaratën sqaruese si *shpenzim në vitin 2003* për apartamentin e deklaruar në vitin 2004 -- subjekti kërkoi që të përfshiheshin kursime të padeklaruara më parë. Konkretisht, subjekti pretendoi se: në vitin 2005 kurseu 500.000 lekë; në vitin 2006 kurseu vlerën 2.150.000 lekë; si dhe në vitin 2008 vlerën 550.000 lekë. Kjo shpërndarje bie ndesh me shpjegimet e subjektit në deklaratën sqaruese se nga viti 1998 deri në vitin 2003 kurseu në total 2.600.000 lekë dhe se deri në vitin 2009, totali i kursimeve të mbartura ishte 3.200.000 lekë.

10.19. Pavarësisht nga mospërputhjet e ndryshimet në vazhdimësi, Komisioni i pranoi edhe këto pretendime tërësisht *deklarative*. Në vendim nuk ka një arsyetim të argumentuar, përse ndonëse Komisioni i dha vlerë provuese deklaratës sqaruese kundrejt deklaratave periodike vjetore apo të gjitha akteve të analizuar në harmoni, nga ana tjetër, gjithsesi, shtoi në mesin e burimeve të deklaruara edhe shuma të pashprehura e konkretizuara në asnjë prej akteve të tjera, deri në rezultatet e hetimit. Për më tepër, një analizë objektive do të duhet të kishte përfshirë në vlerësim edhe faktin që deri në vitin 2003 subjekti nuk kishte mundësi të kursente 2.600.000 lekë me burime të ligjshme, dhe as të shlyente këstin e apartamentit në deklaratën periodike të vitit 2004. Edhe analiza e Komisionit, për mundësinë e krijimit të vlerës 3.200.000 lekë nga viti 2005 – 2009, nuk

përfshihet balanca negative prej 2.600.000 lekësh për vitet 1998-2003, të cilën Komisioni nuk e ka përfshirë as në rezultatet e hetimit.

²⁷ Në tabelën e dorëzuar, në fund të vitit 2003, pasqyrohet shënimi i subjektit “2.600.000 lekë në banesë”, që sipas shpjegimeve të tij, është vlera e shlyer për banesën/apartamentin e deklaruar në deklaratën e vitit 2004.

është e saktë dhe Komisioni ka favorizuar sërish subjektin²⁸. Vetë subjekti nuk ka pretenduar krijimin e kësaj vlere gjatë kësaj periudhe, por e ka shtrirë në vitet 1998 – 2009.

10.20. I njëjti konstatim me mungesë arsytimi të Komisionit, që ka favorizuar analizën për kursimet e subjektit gjën zbatim edhe për sa i përket faktit që subjekti ka marrë përkatësisht një hua dhe një kredi në vitet 2004 e 2006, për nevoja të krijimit të pasurive, respektivisht në vlerat 1.000.000 lekë dhe 35.000 euro. Ndërkohë që subjekti ka pretenduar se kishte likuiditete të lira për përdorim deri në vitin 2009 – marrja e huas dhe sidomos e kredisë me interes bëhet alogjike, pasi nuk ka asnjë kuptim financiar. Për më tepër, shpjegimet e subjektit në Komision se në vitin 2005 kurseu 500.000 lekë dhe në vitin 2006 kurseu 2.150.000 lekë – ndërkohë që mori edhe kredi -- paraqet inkoherenca që sfidojnë logjikën që ka pretenduar subjekti e janë anashkaluar pa arsytim nga Komisioni. Në të njëjtën linjë, edhe pretendimi i marrjes hua në fillim të vitit 2005 nga vjehri, për të blerë një automjet, në kushtet që subjekti pretendonte se kishte gjendje *cash* në banesë me të cilat kishte mundësi të blinte automjetin, e përforcon bindjen se pretendimet e subjektit në deklaratën sqaruese duhet të ishin marrë me rezerva të theksuara nga Komisioni.

10.21. Për sa më lart, saktësia e deklarimeve të subjektit në deklaratat periodike, sikurse Kolegji ka analizuar ndër të tjerë, në jurisprudencën e tij²⁹, nuk përbën objekt vlerësimi nga institucionet e rivlerësimit, por mbështetja në deklaratat periodike vjetore, sidomos kur në fokus janë likuiditete jashtë sistemit bankar, nuk përbën rivlerësim mbi bazën e këtyre deklaratave apo zbatim të një mase disiplinore me fuqi prapavepruese, por mospërputhjet në deklarimin e likuiditeteve *cash* jashtë sistemit bankar për subjektin e rivlerësimit përfshijnë deklaratën *vetting*, pyetësorët dhe qëndrimin e tij në ankimin e paraqitur në Kolegji.

10.22. Nën dritën e garancive procedurale me ankimin, në përmbledhje të sa më sipër, nga kontrolli i analizës financiare dhe vlerësimeve ligjore të kryera nga Komisioni, në Kolegji konfirmohet *më së paku* balanca negative e konstatuar në Komision për vitin 2009, në masën (-) 901.205 lekë, që e vendos subjektin në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për krijimin e pasurisë, sipas germës “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

11. *Apartamenti me vendndodhje në “{***}”, Tiranë*

11.1. Kjo është një ndër pasuritë e deklaruara në deklaratën *vetting*, me vlerë 3.066.000 lekë dhe sipërfaqe 70 m². Subjekti ka deklaruar si burim krijimi të *ardhurat dhe kursimet familjare* dhe referon kontratën e shitjes së datës 11.05.2004. Në deklaratën e parë periodike, hartuar në mars 2004, pasuria në fjalë është deklaruar me vlerë më të ulët, 2.600.000 lekë. Edhe në këtë deklaratë, subjekti ka deklaruar si burime në mënyrë specifike: *nga kursimet familjare*, dhe një truall në qytetin e Sarandës. Komisioni konkludoi se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë pasur mungesë burimesh të ligjshme financiare në shumën (-) 526.317 lekë për blerjen e apartamentit dhe janë, po ashtu, në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme në shumën (-) 111.499 lekë, për kthimin e një huaje prej 8.000 eurosh në vitin 2004, duke u gjendur në kushtet e germës “b” [të pikës 5] të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016. Në këtë konkluzion, Komisioni pranoi shpjegimet e

²⁸ Për vitet 2004 – 2009, u shtua si gjendje *cash* diferenca midis 3.200.000 lekë me 2.600.000 lekë, 600.000 mijë lekë.

²⁹ Paragrafi 19.4.vi.: https://kpa.al/wp-content/uploads/2020/12/Vendimi_Dritan-Peka_i_anonimizuar_per_web.pdf

subjektit se pagesat janë kryer në tre këste³⁰, pranoi burime të reja krijimi, të shtuara gjatë hetimit administrativ [një hua të marrë prej të vëllait të subjektit], ndërsa i gjeti të paprovuara të ardhurat e bashkëshortes nga emigracioni në Greqi, sikurse edhe dhurimin nga i vëllai i subjektit në shumën 3.000 euro, po ashtu emigrant, për shkak të mungesës së dokumentacionit mbështetës. Kjo qasja e Komisionit afekton edhe pasurinë e analizuar në vijim [njësinë e shërbimit], e cila është krijuar në vitin 2003, pak muaj përpara apartamentit.

11.2. Subjekti, në ankim, kundërshton analizën e Komisionit për zëra të veçantë. Konkretisht, shkaqet e ankimit fokusohen në: (i) depozitën e krijuar nga bashkëshortja në datën 03.12.2000; (ii) dhurimin nga i vëllai; dhe (iii) balanca negative e periudhës 1998 – 2003, përveç mospërfshirjes pa të drejtë të dy burimeve të cituar më lart, ka edhe llogaritje të gabuar të shpenzimeve të jetesës së subjektit deri në vitin 1999. Në analizën financiare të kësaj pasurie, subjekti kërkon të përfshihen edhe të ardhurat e bashkëshortes si asistente-avokate në vitet 1999 – 2002, të deklaruara në procesverbalin e ILDKPKI-së, datë 18.07.2016. Sipas tij, Komisioni i ka rënduar pozitën duke mos e pranuar si të ligjshëm dhurimin nga i vëllai “vetëm” se nuk e deklaroi si burim në deklaratën e parë. Ka deklaruar të ardhurat dhe kursimet familjare, duke menduar që shuma e dhuruar u destinua për përballimin e shpenzimeve të jetesës. Sipas subjektit, analiza e Komisionit se subjekti ka bërë deklarime kontradiktore është e pabazuar, pasi i vëllai kishte mundësi të krijonte 2.000 euro në vitin 2001 dhe 1.000 euro në vitin 2002. Depozita e çelur nga bashkëshortja në datën 03.12.2000 u krijua me të ardhurat gjatë punësimit si emigrante në Greqi. Këto të ardhura ka pamundësi objektive t’i provojë me dokumentacion dhe janë të krijuara para martesë³¹, e nuk mund të ngarkohet ai me përgjegjësi. Ekzistenca e të ardhurave gjurmohet nga dokumentacioni bankar dhe mbështetet nga deklarata e xhaxhait të bashkëshortes.

11.3. Në analizë të pretendimeve të subjektit në ankim dhe të vendimit të Komisionit, lidhur me mundësinë financiare, trupi gjykues i Kolegjit arriti në konkluzionin se subjekti gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie dhe mbulimin e shpenzimeve, *më së paku* në vlerën prej (-) 637.816 lekësh të konstatuar në analizën përfundimtare në Komision. Nga ana tjetër, pretendimet e subjektit, të cilat kryesisht konsistojnë në shtimin e burimeve të krijimit të pasurisë në faza të avancuara të procesit të rivlerësimit, u vlerësuan të pabazuara nën dritën e dispozitave ligjore që gjejnë zbatim. Në të njëjtën kohë, pretendimet e subjektit se, ndër të tjera, si burim i krijimit të kësaj pasurie shërbyen edhe të ardhurat e bashkëshortes nga emigracioni, nga puna si asistente avokate përgjatë viteve 2000-2002 apo për të përfshirë vlerën prej 3.000 eurosh të dhuruar nga i vëllai, mbeten të një niveli deklarativ. Ky konkluzion i Kolegjit, mbështetet në analizën që vijon.

11.4. Nga aktet rezulton që subjekti ka porositur këtë apartament në datën 01.10.2001, kundrejt vlerës 26.000 USD, nëpërmjet kontratës së sipërmarrjes lidhur me një person juridik [shoqërinë “{***}” ShPK]. Në kontratë palët kanë rënë dakord se me nënshkrimin e saj do të paguheshin 10.000 USD, ndërsa pjesa tjetër prej 16.000 USD do të paguhej sipas një grafiku që do të përcaktohej prej tyre. Subjekti nuk e ka deklaruar blerjen në deklaratën periodike për vitin 2004. Gjatë kontrollit të kryer nga ILDKPKI-ja, subjekti është shprehur se ka deklaruar pasurinë në

³⁰ Përkatësisht: 3.000 USD në 2001, 7.000 USD në 2003 dhe 16.000 USD në 2004.

³¹ Subjekti dhe bashkëshortja kanë lidhur martesë në datën 13.12.2000.

vlerën 2.600.000 lekë, pasi në datën e dorëzimit të deklaratës, më 31.03.2004, nuk ishte përpiluar ende kontrata e shitblerjes, ndërkohë që çmimi i paracaktuar në shumën 26.000 USD në vitin 2001, ka ndryshuar në vlerën në lekë për shkak të kursit të këmbimit.

11.5. *Së dyti*, në pyetësin standard, për herë të parë subjekti ka deklaruar se si burim për blerjen kanë shërbyer edhe dhurime që vëllai i tij i ka dërguar: afërsisht 2.000 euro në vitin 2001 dhe në vitin 2002 dorazi 1.000 euro *cash*. Subjekti dhe bashkëshortja nuk kanë deklaruar në deklaratën *vetting* se dhurata 3.000 euro nga i vëllai ishte pjesë e burimeve të krijimit të pasurisë apo sjellë akte për ta provuar këtë pretendim. Për më tepër, ky burim nuk është referuar as në deklaratën sqaruese të vitit 2010, bashkëngjitur të cilës subjekti ka paraqitur edhe një tabelë të gjithë të ardhurave dhe shpenzimeve për harkun kohor 1998 deri në fund të vitit 2009. Ky fakt paraqet rëndësi, pasi deklarata sqaruese e arsyetuar gjerësisht më sipër është kryer shumë më afër në kohë me këto ngjarje, ndërsa pyetësi standard gjatë të cilit subjekti ka deklaruar këtë burim për herë të parë daton përrreth 20 vjet më pas nga koha kur subjekti pretendon të ketë qenë përfitues nëpërmjet të ardhurave të vëllait emigrant³². Në të njëjtën linjë, ky burim nuk ka gjetur pasqyrim në asnjë prej procesverbaleve të mbajtura në ILDKPKI.

11.6. Gjatë hetimit administrativ, subjekti ka paraqitur një deklaratë noteriale me datë 02.10.2021, të lëshuar nga vëllai i tij [z. G. K.], nëpërmjet të cilës deklaruesi konfirmon pretendimet e të vëllait për dërgime/kontribut në euro nëpërmjet një agjencie dërgesash (Western Union) dhe dorazi, përkatësisht në vitin 2001 dhe kur ka ardhur vetë, në vitin 2002. Deklaruesi, po ashtu, shprehet se në vitin 2004 i ka dhënë hua subjektit edhe një shumë prej 1.000.000 lekësh, për pak muaj, e që i është kthyer brenda vitit. Për të provuar të ardhurat e vëllait, subjekti paraqiti dokumentacion me vulë apostile nga Instituti Kombëtar i Sigurimeve Shoqërore në Itali (INPS) për vëllanë dhe bashkëshorten e tij, si dhe ekstrakt të aktit të martesës së tyre e vitit 2002. Subjekti ka dorëzuar në Komision dokumentacion për të ardhurat e kumatës, të cilat datojnë para martesës së saj me vëllanë e subjektit.

11.7. Në pyetësin nr. 1, thuajse tre vjet (34 muaj më pas) pasi subjekti i është përgjigjur pyetësit standard, pyetur për kalendarin e pagesave të kështit të dytë, prej 16.000 USD për blerjen e apartamentit objekt analize, në përgjigje³³, subjekti deklaroi se në momentin e lidhjes së kontratës së sipërmarrjes është kryer një pagesë në shumën 3.000 USD të dhuruar nga i vëllai, në vitin 2003 janë paguar 7.000 USD³⁴. Subjekti shpjegoi se pagesa e fundit është kryer në momentin e lidhjes së kontratës së shitjes në vitin 2004, në shumën 16.000 USD. Pagesat u kryen në *cash* dhe nuk ruajt mandate, por vetëm kontratën³⁵. Subjekti pretendoi se në deklaratën periodike për vitin 2003 gabimisht nuk ka deklaruar detyrimin e mbetur ndaj ndërtuesit, por vetëm vlerën e plotë të kontratës së sipërmarrjes për shkak të paqartësive që ka pasur në lidhje me plotësimin e saj.

³² Pyetësi standard mban datën 13.01.2021.

³³ Përgjigjet e pyetësit nr. 1, të datës 24.11.2023.

³⁴ Pra, në ndryshim nga përcaktimi në kontratën e sipërmarrjes, subjekti deklaroi se kësti i parë prej 10.000 USD u pagua në dy vite të tjera dhe jo sipas përcaktimeve kontraktuale.

³⁵ Shoqëria “{***}” ShPK përcolli pranë Komisionit kontratën e sipërmarrjes dhe kontratën e shitjes, ndërsa lidhur me dokumentacionin provues të pagesës së çmimit, sqaroi se nuk e disponon për shkak të kohës së gjatë që ka kaluar.

11.8. Komisioni pranoi gjithë shpjegimet e mësipërme, qoftë për kalendarin e pagesave dhe mospërputhjen e çmimit të deklaruar me atë të sipas kontratës, duke e gjetur bindës shpjegimin se gabimisht subjekti ka deklaruar vlerën e plotë të kontratës së sipërmarrjes dhe jo detyrimin e mbetur ndaj ndërtuesit. Për rrjedhojë, në analizën e kryer për pagesat e kësteve, Komisioni përlllogariti 3.000 USD të shlyer në vitin 2001, 7.000 USD në vitin 2003 dhe 16.000 USD në vitin 2004. Komisioni përfshiu të ardhura të konfirmuara nga sigurimet shoqërore për punësimin e bashkëshortes për periudhën 1999-2000, nga marrëdhënie të punës.

11.9. Komisioni përfshiu në analizën financiare huan nga vëllai i subjektit, pretenduar për herë të parë me një deklaratë noteriale të vitit 2021, por jo dhuratën, duke e quajtur deklarative dhe të pambështetur në prova, pasi u deklarua për herë të parë në pyetësonin standard, nuk kishte gjurmë të mëparshme dhe mungon dokumentacioni ligjor për të provuar dërgimin e shumës 2.000 euro në vitin 2001 nëpërmjet Western Union. Të ardhurat në vlerën 452.448 lekë, që, sipas subjektit, ishin nga punësimi i bashkëshortes në emigracion, nuk përmbushin standardin e të ardhurave të ligjshme, sipas pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Me këtë arsyetim, Komisioni nuk pranoi as pretendimet për të përfshirë në analizë të ardhurat e kumatës së subjektit përpara martesë, në kushtet që dhurata pretendohet prej të vëllait.

11.10. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se pretendimet e subjektit kanë mospërputhje të rëndësishme me aktet. Këto mospërputhje pasqyrohen në të dhënat e deklaruara për vlerën reale të kësteve për blerjen e apartamentit, kohën e kryerjes së pagesave përkatëse dhe burimeve të financimit të kësaj pasurie. Subjekti nuk ka bërë deklaram të qartë, të saktë dhe të verifikueshëm në lidhje me burimet financiare të përdorura për blerjen e apartamentit, as në kuadër të procesit të rivlerësimit (deklaratën *vetting*), as në deklaratat periodike vjetore, e as në ndonjë deklaram të mëhershëm pranë ILDKPKI-së. Të dhënat dhe sqarimet lidhur me burimet financiare duket se janë paraqitur për herë të parë gjatë shqyrtimit administrativ nga Komisioni, çka lë të kuptohet se ekziston mundësia që të jenë paraqitur me qëllim përmirësimin retrospektiv të analizës financiare.

11.11. Komisioni ka pranuar një sërë pretendimesh, të cilat kanë afektuar analizën në favor të spikatur të subjektit dhe pavarësisht prej zigzageve të pohimeve e pretendimeve të tij. Në këtë mënyrë, pa arsyetim, Komisioni i ka dhënë peshë përcaktuese e vendimtare burimeve dhe sqarimeve të paraqitura rishitazi, të cilat përmirësojnë analizën financiare të subjektit, pavarësisht mungesës së deklarimeve të mëparshme të detyrueshme apo pamjaftueshmërisë së konkluduar në përfundim të rezultateve të hetimit. Ndryshe nga sa palët kanë referuar në mënyrë të shprehur në kontratën e sipërmarrjes dhe vlerën provuese që kanë kontratat e lidhura rregullisht³⁶, ndryshimi i shlyerjes së kësteve pranuar nga Komisioni, sipas pretendimit të subjektit, nuk gjen mbështetje ligjore në akte. Nga aktet e administruara gjatë hetimit administrativ, rezulton se në asnjë çast gjatë kësaj marrëdhënieje detyrimi palët nuk kanë bërë ndonjë shënim [në kontratën pasardhëse të vitit 2004], për të pasqyruar pretendimet për pagesat e kryera në këste apo afate të ndryshme nga ato të parashikuara, pra, të ndonjë ndryshimi me pëlqimin e palëve. Në këtë mënyrë, ndryshimi i kalendarit të shlyerjes së kësteve nuk duhet të jetë pasqyrim i situatës reale. Për këtë shkak,

³⁶ Neni 690 i Kodit Civil, parashikon se: “Kontrata e lidhur rregullisht ka forcën e ligjit për palët. Ajo mund të prishet ose të ndryshohet me pëlqimin e ndërsjellë të palëve ose për shkak të parashikuara me ligj”.

shpërndarja në mënyrë tillë nga Komisioni përbën një favorizim për subjektin dhe një kapërcim të paarsyeshëm nga rezultatet e hetimit në vendim.

11.12. Pretendimet e subjektit për burimet e krijimit, të shtuara rishtazi gjatë procesit të rivlerësimit, janë të pabesueshme parë në disa aspekte. Në kushtet që Italia ka adoptuar euron vetëm në 1 janar 2002, ndërsa më herët euro ishte vetëm “në letër”, subjekti dhe i vëllai do të pritej t’i referoheshin vlerës në lireta, sikurse ai duhet të ishte paguar. Edhe në një deklaratë noteriale, kunata shprehet edhe se vëllai i subjektit punonte i *pasiguruar*. Në këto kushte, dhe duke pasur në konsideratë që ai [i vëllai] ka rezultuar në kushtet e pamundësisë së krijimit të vlerës 2.000 euro në vitin 2001³⁷, edhe parë në këtë këndvështrim, dhurimi zbehet si potencial, edhe duke abstraguuar nga moskalimi i testit të ligjshmërisë. E njëjtë paraqitet situata edhe për dhuratën në vlerën e pretenduar prej 1.000 eurosh në vitin 2002 -- vëllai i subjektit ishte në pamundësi për të përballuar shpenzimet bazike të jetës për vete, gjë që përjashton mundësinë e dhurimeve³⁸.

11.13. Subjekti është i pabesueshëm për harresën e deklaramit të këtij burimi apo shlyerjen e detyrimeve. Përpos faktit që subjekti kishte detyrimin kushtetues të deklaronte saktësisht burimet e krijimit të pasurisë, zërthyer qartë në ligj dhe në Udhëzimin nr. 4095/2016, të ILDPKPKI-së e, për pasojë, harresa është e pakuptimtë, duke pasur parasysh detajet e shtjelluara në tërësi nga normativa e rivlerësimit që e bëjnë të pakuptimtë harresën në vitin 2017, por jo në vitin 2021, trupi gjykues çmon të theksojë edhe që subjekti ka korrektuar deklaramit e tij shumë herë përpara deklaratës *vetting*. Nga të gjitha këto këndvështrime, harresa deri në vitin 2021 është e paargumentueshme logjikisht. Për më tepër, fakti që subjekti ka qenë i qartë dhe e ka kuptuar saktë mënyrën sesi duhet të deklaronte rezulton nga mënyra sesi ka deklaruar qoftë në vitet 2010-2015 [arsyetuar më sipër] ato aspekte që i është dashur t’i deklarojë, qoftë më herët, në deklaratën periodike për vitin 2004. Në këtë deklaratë, kur ka deklaruar pasurinë tjetër [njësi me sipërfaqe 40 m²], subjekti ka deklaruar saktësisht vlerën *e shlyer* te ndryshimi i pasurive dhe detyrimin *e mbetur* ndaj sipërmarrësit në seksionin e detyrimeve ndaj të tretëve. Detyrimin ndaj sipërmarrësit për këtë pasuri të blerë në vitin 2003, subjekti e ka deklaruar edhe në deklaratën e vitit 2007 dhe në deklaratën *vetting*. Ky fakt hedh poshtë argumentet për “harresë” të parashtruara për krijimin e kësaj pasurie, duke përforcuar bindjen se në vend të së vërtetës, subjekti sjell argumente për të anashkaluar situatën në të cilën ndodhet.

11.14. Trupi gjykues i Kolegjit e gjen të bazuar qëndrimin e Komisionit për të mos përfshirë në mesin e burimeve të ligjshme të disponuara nga subjekti të ardhura nga punësimi i bashkëshortes në emigracion [në Greqi]. Këto të ardhura, sipas subjektit, kanë shërbyen si burim për çeljen e krijimit të depozitës bankare në datën 03.12.2000. Nga aktet në fashikull rezulton se gjatë hetimit, subjekti ka ndryshuar burimin financiar që ka ushqyer këtë depozitë. Konkretisht, ndërsa në deklaratën e parë periodike, hartuar në mars 2004, subjekti është shprehur se depozita prej 2.470 USD ka si burim *kursimet nga paga*, në ankim dhe gjatë hetimit administrativ, subjekti ka kërkuar që të përfshihen në mesin e burimeve të ligjshme shuma prej 1.175.000 dhrahmi greke, që sipas tij

³⁷ Sipas akteve, rezulton se vëllai i subjektit provon të ketë fituar deri në 223 euro të ardhura bruto në muaj nga puna, ndërkohë që shpenzimet e jetesës sipas EUROSTAT, të përllogaritura nga Komisioni ishin në total 6.240 euro për person në vit.

³⁸ Si më sipër, vëllai i subjektit provon të ketë gjeneruar në total 3.729 euro për vitin, ndërsa shpenzimet e jetesës ishin 7.210 euro për person.

përbën fitime të bashkëshortes nga një punësim në Greqi, meqenëse kjo depozitë është çelur përpara martese -- 10 ditë më herët. Subjekti ka paraqitur në cilësinë e provës një deklaratë noteriale të xhaxhait të bashkëshortes, që konfirmon qëndrimin e saj në Greqi.

11.15. Konkluzioni i mësipërm mban në konsideratë disa aspekte. E para, ndonëse formalisht depozita është çelur përpara martese, distanca 10-ditore është e papërfillshme për efekt të analizës së ndërthurjes së interesave. Për më tepër, subjekti e bashkëshortja janë bërë me fëmijë tre muaj më pas. Ky fakt përforcon bindjen që interesat e tyre personale e pasurore tashmë duhen parë të ndërthurura e harku kohor 10-ditor nuk përjashton objektivisht kontributin në mos tërësor, më së paku të pjesshëm të subjektit në krijimin e kësaj pasurie. Ky argument – fakti që pasuria i përket një periudhë përpara martese apo që fondet janë nga punësimi i saj në Greqi -- do të bënte kuptim nëse bashkëshortja do ta kishte çelur depozitën pasi këto të ardhura janë krijuar – në vitet 1998-1999. Mbi të gjitha, mungesa e ndonjë prove a indicieje, qoftë edhe rrethanore, për punësimin apo qëndrimin në Greqi, e bën pranimin e kësaj shumë në mesin e burimeve të ligjshme të papranueshme. Subjekti nuk ka sjellë kopje të pasaportës së bashkëshortes apo vulë të vendosur nga policia kufitare që tregon udhëtimin nga ose për në Greqi apo të dhëna të tjera. Deklarata noteriale e lëshuar nga xhaxhai i bashkëshortes gjatë procesit të rivlerësimit, i cili shprehet se ka jetuar në Greqi dhe ka strehuar edhe mbesën/bashkëshorten e subjektit në shtëpinë e tij në vitet 1998-1999 [dhe në vitin 2010], nuk ka të dhëna që të provojnë qoftë qenien e tij në Greqi në vitet në fjalë apo më pas e, për më tepër, asnjë të dhënë që mund të provojë llojin e punës së kryer prej saj apo pagat në nivel sasior, duke e përjashtuar edhe teorikisht kalimin e testit të ligjshmërisë së tyre.

11.16. Pretendimi tjetër i subjektit se këto të ardhura përfaqësonin *pajën* e bashkëshortes, një *praktikë e njohur në traditën shqiptare* dhe, si të tilla, nuk ishin objekt detyrimi për deklaram, është i pakuptimtë krahasuar me dinamikën e prezantuar nga subjekti në tërësi dhe formimin e tij dhe të bashkëshortes, profesional e social. Subjekti prezanton banim afatgjatë me prindërit e bashkëshortes në banesën e këtyre të fundit, të cilët kontribuojnë për përfitime financiare të subjektit e bashkëshortes, ndërsa bashkëshortja punon me kohë të plotë, sikurse edhe subjekti. E thënë ndryshe, kjo mënyrë jetese duket tejet e largët nga konceptet arkaike tradicionale e folklorike që bazonin kontributin financiar në *pajë*, edhe duke abstraguat nga profili profesional, arsimor dhe financiar i bashkëshortes dhe subjektit si dy juristë karriere.

11.17. Pretendimi i subjektit për pamundësi objektive për të provuar ligjshmërinë e këtyre të ardhurave me dokumentacion, nën dritën e pikës 2 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, lidhur me pretendimin se janë të krijuara para martese, është i pabazuar tërësisht. *Së pari*, pamundësia objektive, sipas dispozitës së sipërcituar, kërkon si kusht të domosdoshëm që të ardhurat të kenë ekzistuar përtej çdo dyshimi – pasi referohet pamundësi për të provuar ligjshmërinë e të ardhurave -- dhe që subjekti të ketë bërë përpjekje për t'i provuar³⁹, në mënyrë kumulative. Përpos sa analizuar e arsyetuar më sipër, për shkaqet për të cilat pretendimet e subjektit janë të pabesueshme

³⁹ “2. Nëse subjekti i rivlerësimit është në pamundësi objektive për të disponuar dokumentin që justifikon ligjshmërinë e krijimit të pasurive, duhet t'i vërtetojë institucionit të rivlerësimit se dokumenti është zhdukur, ka humbur, nuk mund të bëhet përsëri ose nuk merret në rrugë tjetër. Institucionet e rivlerësimit vendosin nëse mosparaqitja e dokumenteve justifikuese është për shkaqe të arsyeshme. Ky rregull zbatohet edhe në ato raste kur organi përgjegjës për lëshimin e dokumenteve justifikuese nuk përgjigjet brenda afatit ligjor. [...]”

për ekzistencën e këtyre të ardhurave, theksojmë që subjekti jo vetëm nuk ka lënë asnjë gjurmë ndër vite të prejardhjes së tyre nga punësimi i bashkëshortes, por ia ka atribuuar ato kursimeve të tij nga paga. Sikurse theksuar më sipër, në deklaratën *vetting*, dhe në deklaratën e parë të vitit 2003 [hartuar në mars 2004], nuk ka asnjë referencë të ardhurash nga emigracioni apo të ardhura në ekonominë familjare, pasi janë krijuar përpara martesë. Edhe në deklaratën sqaruese të subjektit, për harkun kohor 1998-2009, ai nuk ka specifikuar dhe as i ka atribuuar të ardhura/përfitime ekonomisë familjare nga punësimi i bashkëshortes përpara vitit 2000.

11.18. Këto aspekte janë në kontrast të dukshëm me rrethanat faktike të konstatuara nga GjEDNj-ja në çështjen *Sevdari* kundër Shqipërisë. Në atë çështje, të ardhurat nga emigracioni ishin *materializuar* në një pasuri, të krijuar përpara martesë, nga njëra anë, ndërsa subjekti *Sevdari*, jo vetëm që nuk mund të argumentojë se kishte ndonjë kontribut, por *nuk* ishte as prokurore. Në rastin konkret, subjekti i rivlerësimit Madrid Kullolli është emëruar OPGj në janar 1998, në Sarandë – qytet kufitar me Greqinë dhe me lidhje të ngushta sociale/ekonomike me atë vend – është emëruar prokuror po aty në vitin 1998, ndërsa depozita është krijuar dy vite më pas, në një kohë gjatë së cilës ai vijonte të ishte prokuror, dhe subjekti e bashkëshortja prisnin një fëmijë dhe ishin edhe duke kurorëzuar lidhjen me martesë ligjore. Për të gjitha këto rrethana, dhe ato të ilustruara më sipër në funksion të mungesës së indicieve e vetëdeklarimeve të kohës që provojnë pretendimet e subjektit në procesin e rivlerësimit, analizuar në çdo këndvështrim, ngjashmëria me çështjen *Sevdari* është sipërfaqësore dhe asnjë kriter kontrollues që mund të gjejë zbatim te subjekti.

11.19. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se edhe për të ardhurat e pretenduara të bashkëshortes së subjektit si asistente-avokate përgjatë vitit 1999, nuk u gjet asnjë gjurmë, qoftë për ekzistencën e tyre/marrëdhënien e punësimit apo përfitimin në nivelin sasior. Ndër aktet në fashikull nuk rezultojnë asnjë dokumentacion justifikues ligjor. Libreza e punës së bashkëshortes së subjektit, administruar në Komision, pasqyron hapjen nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive, Sarandë, në datën 20.03.2000, si datën e parë të nisjes së punës. Sikurse për të ardhurat e pretenduara të saj nga emigracioni, edhe për këtë zë, në deklaratën sqaruese të hartuar nga subjekti [deklarata pa datë, arsyetuar gjerësisht më sipër], edhe për këtë zë subjekti nuk atribuon prurje në ekonominë familjare për harkun kohor nga viti 1998 – 2009. Në atë deklaratë, subjekti nuk deklaroi të ardhura të bashkëshortes deri në vitin 2000. Për herë të parë, në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI në datën 18.07.2016, subjekti deklaroi se bashkëshortja e tij nga viti 1999 – 2003 [kur u regjistrua si person fizik në gjykatë] ka përfituar të ardhura si asistent avokate, sipas vlerave të deklaruara prej tij. Përpos kësaj reference, nuk ka asnjë akt mbështetës për të provuar qoftë edhe indirekt e në formë indicieje për ekzistencën e kësaj marrëdhënieje punësimi. Për këto të ardhura, në fashikuj janë administruar ndër të tjerë: vërtetimi i lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Durrës, datë 25.01.2017, dërguar me deklaratën *vetting* në ILDKPKI dhe deklaratimet e para të bashkëshortes së subjektit pasqyrohen duke filluar nga viti 2003, si qarkullim/xhiro.

11.20. Pretendimi i subjektit për llogaritje gabim të *shpenzimeve të jetesës* deri në vitin 1999 nuk qëndron. Nga kontrolli i analizës financiare të kryer në Komision, rezultojnë se për vitet 1998 dhe

1999, në përputhje me jurisprudencën e Kolegjit⁴⁰, shpenzimet e jetesës së subjektit janë përlllogaritur në masën e 30% të të ardhurave, duke marrë shkas nga fakti që subjekti ishte në detyrën e prokurorit.

11.21. *Së fundmi*, subjekti pretendon se balanca negative e periudhës 1998-2003, si vlerë e shpërndarë ndër vite, duhet të vlerësohet në zbatim të parimit të proporcionalitetit. Ky kërkim është i pakuptimë e i pabazuar, pasi sikurse është arsytuar gjerësisht më sipër [ndër të tjerë, në paragrafët 10.18, 10.19 dhe poshtëshënimin nr. 26], balanca negative e referuar në konkluzionin përfundimtar është rezultati që përftohet pasi Komisioni ka pranuar thujtë *të gjitha* pretendimet e tij të përshtatura me momentin dhe me efekt prapaveprues e zhbërës të gjithë deklaratimeve të kryera ndër vite. Përkundër kontratës së sipërmarrjes dhe vlerës provuese që ka ajo, Komisioni kreu përlllogaritjen e pagesave, sipas kalendarit të propozuar dhe deklarativ të subjektit, duke i shpërndarë pagesat në tre këste dhe pranoi edhe një hua të përmendur për herë të parë si burim krijimi pasurie në vitin 2021, pretenduar dhënë në vitin 2004, si dhe kreu edhe analizë financiare të vëllait të subjektit.

11.22. Për më tepër, sikurse theksuar më sipër, edhe fakti që subjektit i është nevojitur “Deklarata sqaruese” u arsytua se bën kuptim vetëm si pasojë e faktit që subjekti kishte krijuar tri pasuri të paluajtshme dhe krijuar kursime e depozita bankare⁴¹ të krijuara deri në vitin 2003 – referuar më sipër në paragrafin 10.17. Për pasojë, duke qenë kjo balancë varianti më i mirë i mundshëm, dhe nën dritën e faktit që nëse analiza do të kryhej në përputhje me vlerën provuese të akteve zyrtare, balanca deri në vitin 2003 do të ishte më afër asaj të referuar në rezultatet e hetimit [arsytuar në vijim]⁴², ky pretendim është i pabazuar. Subjekti është i pabesueshëm në tërësi në kontrollin e pasurisë dhe në kushtet që pavarësisht nga anashkalimi i shumë aspekteve duke e favorizuar atë, mbetet gjithsesi një balancë negative përtej asaj për të cilën Kolegji ka vlerësuar se ka vend për proporcionalitetin, ky argument nuk gjen asnjë bazë.

11.23. Për sa më sipër, nga një përlllogaritje ushtrimore e kryer bazuar në vlerën e plotë të pasurisë, që në kontratën e sipërmarrjes referohet 26.000 USD, ndërsa në atë të shitjes së datës 11.05.2004 referohet 3.066.000 lekë, rezulton edhe një diferencë çmimi e paguar e pakontestuar, që nuk është llogaritur, prej përreth 100.000 lekësh. Nga ana tjetër, në kushtet që në deklaratën e parë të vitit 2003, subjekti nuk deklaroi detyrime të mbetura ndaj firmës së ndërtimit, dhe që në deklaratat sqaruese të viteve në vijim nuk ka referencë korrektuese, prezumohet që detyrimet duhet të ishin shlyer. Duke ndjekur këto elemente, analiza financiare e subjektit, bazuar në parashikimet kontraktore, në analizën e kryer nga Kolegji për efekt të qartësimit të gjithë panoramës që rezulton si pasojë e shkaqeve të ankimit, balanca negative e përfutur në analizën përfundimtare të Komisionit është produkti i analizës financiare *më të favorshme* të mundur.

⁴⁰ Shih vendimin e Kolegjit që i përket subjektit të rivlerësimit, Kastriot Selita.

⁴¹ Shih edhe paragrafin 10.17. Deri në mars 2004, subjekti pretendon të ketë krijuar “me kursime” me burim “të ardhurat personale nga paga e tij”: (1) apartament me vlerë 2.600.000 lekë, në Tiranë [te {***}]; (2) truall me sipërfaqe 243 m² në Sarandë; (3) depozitën bankare 2.470 USD; dhe (4) shlyer 36.000 USD për kontratën e sipërmarrjes për zyrën dhe më pas, me deklaratën sqaruese pa datë, pretendon se deri në vitin 2003 kurseu 2.600.000 lekë.

⁴² Konkretisht, për harkun kohor 1998-2003, Komisioni ka konstatuar balancë negative financiare në vlerën (-) 1.392.426 lekë. Në analizën e kryer në Kolegji, konfirmohet kjo balancë më së paku.

11.24. Konkretisht, analiza ushtrimore e kryer në Kolegj tregon një balancë negative mbi dyfish më të lartë për dy këstet⁴³. Në këtë kontekst u përllogarit: (i) shuma 10.000 USD, e paguar në momentin e nënshkrimit të kontratës së sipërmarrjes, konvertuar me kursin zyrtar të këmbimit të monedhës në fuqi në datën përkatëse të nënshkrimit; (ii) diferenca ndërmjet çmimit total të pasurisë dhe këstit të parë të paguar u konsiderua e shlyer në datën e lidhjes së kontratës, në mungesë të provave dokumentare të pagesave të mëvonshme; (iii) shuma 3.000 euro e pretenduar si dhuratë dhe shuma 1.000.000 lekë e pretenduar si hua nga vëllai dhe të gjitha të ardhurat e padeklaruara më parë nga emigracioni i bashkëshortes apo si asistente-avokate e saj, nuk u përllogariten si burime financimi, pasi janë deklaruar për herë të parë vetëm në hetimin administrativ, dhe duke përfshirë, sikurse edhe në Komision, të ardhurat nga punësimi i bashkëshortes në ZVRPP gjatë vitit 2000. Në kuadër të mospërkeqësimit të pozitës së subjektit, për efekt të garancive procedurale me ankimin, trupi gjykues i Kolegjit përfshiu në analizë vetëm balancën negative të konkluduar nga Komisioni për krijimin e kësaj pasurie, në vlerën (-) 637.816 lekë.

11.25. Në këto kushte, pretendimet e subjektit që lidhen me analizën financiare të periudhës 1998 – 2003, dhe pretendimet për përfshirjen në analizë të disa burimeve për të cilat ai nuk ka paraqitur dokumentacion ligjor, janë të pambështetur në prova dhe në ligj, duke e vendosur subjektin, gjithsesi, në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme të krijimit të pasurisë, sipas germës “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

12. *Njësi shërbimi me sipërfaqe 40 m², në Bulevardin “{***}”, në Tiranë*

12.1. Në deklaratën *vetting*, subjekti ka deklaruar pasurinë në fjalë të krijuar me kontratën e sipërmarrjes së datës 06.10.2003, me një vlerë 36.000 USD të shlyer dhe 4.000 USD si detyrim ndaj sipërmarrësit. Si burim të krijimit të pasurisë, subjekti deklaroi të ardhurat dhe kursimet familjare. Bashkëlidhur deklaratës *vetting*, në ILDKPKI, subjekti ka paraqitur kontratën e sipërmarrjes së datës 06.10.2003, të lidhur me shoqërinë ndërtuese [“{***}” ShPK] për ambient zyre me sipërfaqe 40 m², në vlerën 40.000 USD. Sipas kontratës, pagesa do të bëhej nëpërmjet kësteve si vijon: 25.000 USD në datën e nënshkrimit të kontratës; kësti i dytë 11.000 USD në datë 10.12.2003 dhe në datën 31.1.2004 do të bëhej dorëzimi i objektit dhe do të paguhej diferenca prej 4.000 USD. Gjithashtu, subjekti ka bashkëlidhur edhe depozitimet bankare të kryera në Tirana Bank për shumën 25.000 USD në datën 06.10.2003 dhe për shumën 11.000 USD në datën 12.12.2003, në të cilët referohet pagesa e kryer nga bashkëshortja me përshkrimin “*shlyerje kontratë sipërmarrje nr. {***}/ {***}*”.

12.2. Komisioni konkludoi se pamundësia e krijimit të pasurisë ishte në vlerën (-) 882.576 lekë, duke e vendosur subjektin në kushtet e germës “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016. Ky rezultat është pasojë e pranimit të kalendarit të pagesave të apartamentit, sipas pretendimeve të subjektit e jo kontratës, sikurse edhe të përfshirjes në mesin e burimeve të ligjshme të disponuara

⁴³ Nga kontrolli i analizës së Komisionit në Kolegj, bazuar në aktet në fashikull, përcaktimet kontraktore dhe burimet e krijimit të pasurisë sipas deklaratës *vetting*, balanca negative për dy këstet do të rezultonte në shumën totale (-) 1.351.420 lekë. Nga kjo shumë, kësti i parë, i paguar sipas kontratës së sipërmarrjes, do të rezultonte me balancë negative prej (-) 400.000 lekë (rrumbullakosur) ndërsa i dyti në vlerën (-) 951.000 lekë (rrumbullakosur).

të; (i) një *teprice pozitive të mbartur* në vlerën 591.106 lekë⁴⁴; dhe (ii) të ardhura nga paga e subjektit dhe bashkëshortes.

12.3. Kërkimet e subjektit të rivlerësimit, për këtë shkak ankimi, përputhen me ato për pasurinë e sipëranalizuar për shkak të kohës kur këto dy pasuri janë krijuar, përkatësisht në tetor 2003 e vijim dhe maj 2004. Konkretisht, dhe pa përsëritur sa më sipër, subjekti i rivlerësimit kërkon që në mesin e burimeve të ligjshme të disponuara për efekt të krijimit të kësaj pasurie të përfshihen tre burimet e shtuara prej tij gjatë hetimit administrativ [dhurata financiare nga i vëllai emigrant, shuma e depozituar në bankë në dhjetor 2000, që pretendohet të jetë krijuar me të ardhurat e bashkëshortes nga emigracioni, si dhe të ardhurat nga angazhimi si asistente-avokate në mars-dhjetor 2000, përlllogaritur pa shpenzime jetese, meqenëse ajo jetonte me prindërit. Sipas subjektit, përfshirja e këtyre të ardhurave të plota, pa përlllogaritur shpenzime jetese të bashkëshortes, do të passillte balancë pozitive në datën 12.12.2003.

12.4. Sikurse referuar e shtjelluar gjerësisht më sipër, pretendimet e subjektit për krijimin e kësaj pasurie iu nënshtruan kontrollit edhe në analizën e apartamentit në Tiranë dhe nuk u konsideruan të justifikuara me dokumentacion ligjor. Nga kontrolli i analizës së kryer në Kolegj, në vijim të këtyre qëndrimeve dhe në kuadër të mospërkeqësimit të situatës së subjektit në ankim, edhe për këtë pasuri konfirmohet *minimalisht* pamundësia financiare në vlerën e konstatuar nga Komisioni, prej (-) 882.575 lekësh, që gjithsesi e vendos subjektin në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme, parashikuar nga germa “b” e pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016. Këtë konkluzion, Kolegji e arriti pas një analize të detajuar të pretendimeve të subjektit, përkundër një kontrolli të akteve në fashikuj dhe të shpjegimeve përgjatë kontrollit, që shtjellohet në vijim.

12.5. Në deklaratën e parë periodike vjetore, të dorëzuar në datën 26.05.2004 -- që nënkupton pas nënshkrimit të kontratës -- subjekti nuk deklaroi veprimet për efekt të krijimit të pasurisë. Në deklaratën periodike për vitin 2004, në mars 2005, ai deklaroi kontratën dhe detyrimin e mbetur. Ky deklaram përputhet me deklaratën *vetting*. Detyrimin 4.000 USD të mbetur ndaj shoqërisë, subjekti e ka deklaruar edhe në deklaratat periodike të vitit 2007, 2012 e deri në deklaratën *vetting*. Pyetur nga ILDKPKI-ja, në korrik 2016, për arsyet e mosdeklarimit të kësaj pasurie me deklaratën e parë periodike për vitin 2003 [në mars 2004], në kushtet që kishte paguar 36.000 USD gjatë vitit 2003, subjekti është shprehur se nuk ka kuptuar ligjin për nëse duhet të deklaronte ndonëse nuk ishte lidhur kontratë shitblerjeje. Më datë 01.12.2006 janë kryer saktësimet lidhur me vlerën e shlyer dhe detyrimin e mbetur pa likuiduar, është shprehur subjekti. Edhe në atë moment kohor, për këtë pasuri, subjekti ka referuar si burime krijimi të ardhurat familjare të tij dhe bashkëshortes.

12.6. Nga aktet në fashikull, dhe në një lexim të kombinuar të fakteve e sa rezulton nga dokumentacioni, për sa i përket kronologjisë kohore të krijimit të kësaj pasurie dhe apartamentit të sipëranalizuar, trupi gjykues i Kolegjit çmon të nxjerrë në pah disa aspekte me rëndësi për qartësimin e ndërthurjes së analizave. Konkretisht:

⁴⁴ Të njëjtën logjikë, duke përfshirë një “teprice pozitive të mbartur nga periudha e mëparshme”, Komisioni e shtoi edhe tek apartamenti te {***}.

(a) Në datën 1.10.2001, subjekti ka porositur apartamentin në rrugën “{***}”, sikurse theksuar më sipër. Çmimi sipas kontratës citohet 26.000 USD/ekuivalenti i 3.681.080⁴⁵ lekëve. Sipas kontratës, në atë datë [1.10.2001], subjekti ka paguar 10.000 USD ose 1.415.800 lekë, ndërsa pjesa tjetër do të paguhej në vijim në dakordësi mes palëve. Kontrata e shitjes është nënshkruar më 11.05.2004, për çmimin 3.066.000 lekë – një vlerë më e ulët krahasuar me atë të kontratës së sipërmarrjes. Cilido kalendar pagesash të përdoret, nga ky akt duhet të prezumohet se deri në këtë datë, subjekti kishte shlyer në tërësi vlerën prej 3.066.000 lekësh.

(b) Në datën 06.10.2003, subjekti ka porositur edhe njësinë objekt analize në këtë rubrikë, kundrejt çmimit prej 40.000 USD, nga të cilat 36.000 USD ose 4.077.550 lekë⁴⁶ janë paguar në harkun kohor tetor-dhjetor 2003. Shitblerja e njësisë nuk ka qenë finalizuar deri gjatë hetimit administrativ në Komision.

(c) Subjekti nuk ka deklaruar asgjë lidhur me këtë pasuri në deklaratat periodike vjetore deri në mars 2005. Nga ana tjetër, apartamentin e sipëranalizuar subjekti e ka deklaruar që në rastin e parë, me deklarimin për vitin 2003, por me çmim të reduktuar dukshëm, prej 30% më pak të vlerës së vërtetë [2.600.000 lekë kundrejt 3.681.000 lekë].

(d) Të ardhurat e subjektit arrinin në vlerën 2.248.722 lekë, për periudhën dhjetor 2000-nëntor 2003. Të ardhurat e bashkëshortes arrinin në totalin e rrumbullakosur prej 1.700.000 lekësh, nga të cilat 1.600.000 lekë vetëm duke nisur nga një datë e papërcaktueshme në mars 2003, pas regjistrimit të aktivitetit të saj si avokate në gjykatë më 03.03.2003. Paga të mëparshme të bashkëshortes, sikurse deklaruar nga vetë subjekti paraqiten në një vlerë modeste për vitin 2000 gjatë punësimit në ZVRPP⁴⁷, ndërsa nuk ka të dokumentuara dhe as u pranuan pretendimet deklarative në pyetësorë, analizuar më sipër për arsyet përse janë të pabesueshme. Në total, të ardhurat e bashkëshortëve Kullolli për këtë periudhë kohore janë përreth 4.000.000 lekë, rrumbullakosur⁴⁸.

12.7. Nga sa më sipër përmbledhur rezulton se në harkun kohor mes tetorit 2001 dhe majit 2004, subjekti dhe personi i lidhur kanë investuar në së paku dy pasuri, në total në vlerën 4.150.120 lekë dhe 3.066.000 lekë – duke pranuar variantin financiar të përdorur nga Komisioni ose 7.216.120 lekë. Nga logjika e thjeshtë aritmetike, qartazi duket që subjekti e bashkëshorti kanë investuar e krijuar pasuri që tejkalojnë të ardhurat e tyre të kombinuara me më së paku 45% më tepër. Nëse në këtë përlllogaritje do të përfshiheshin shpenzimet modeste të jetesës për këtë periudhë kohore⁴⁹, raporti mes të ardhurave të mbetura e të disponueshme për konsum/kursime e investime me të ardhurat e jetesës shkon në 43% ose që pasuritë e krijuara tejkalojnë të ardhurat e disponueshme më më së paku 57%. Kjo analizë do të thellohej edhe më tej në disfavor të të ardhurave nëse mbahet në konsideratë që për efekt të kësaj llogarie pjesa dërrmuese e të ardhurave të bashkëshortes [1.600.000 milionë l kundrejt 0.7 milionë lekë] është krijuar për përreth nëntë (9) muaj në vitin

⁴⁵ Sipas kursit të këmbimit të Bankës së Shqipërisë në:

https://www.bankofalbania.org/Tregjet/Kursi_zyrtar_i_kembimit/Arkiva_e_kursit_te_kembimit/

⁴⁶ Sipas kursit të këmbimit të Bankës së Shqipërisë përkatësisht në datat e kryerjes së pagesave.

⁴⁷ Në deklaratën sgaruese pa datë të subjektit, nga ai vetë është shënuar si pagë të bashkëshortes për gjithë vitin 2000, shuma në vlerën 88.201 lekë.

⁴⁸ Vlera ekzakte nga aktet rezulton 3.970.137 lekë.

⁴⁹ Përlllogaritur sipas përbërjes familjare në total në vlerën 805.666 lekë.

2003, pas regjistrimit të aktivitetit të saj privat si avokate. Deri në atë datë, shpenzimet dhe investimet në pasuri të ndryshme pretendohen të jenë krijuar me të ardhurat e subjektit prokuror.

12.8. Pavarësisht nga panorama e mësipërme, e dukshme nga aktet dhe nga fakti që subjektit i janë nevojitur dy deklarata sqaruese ndër vite në përpjekje për mundësuar anashkalimin e problematikave që janë lehtësisht të konstataueshme, pasi ka konstatuar një balancë negative prej (-) 1.473.681 lekësh, Komisioni, në përfundim e me favorizimin e radhës, ka pranuar një sërë argumentash – kryesisht në sajë të kalendarit të ndryshuar të pagesës së pasurisë tjetër. Balanca negative e përfutur për krijimin e kësaj pasurie është ajo më garantiste e mundshme, në rrethanat konkrete.

12.9. Pa përsëritur vlerësimin e shtjelluar më sipër për pabazueshmërinë e qëndrimit të Komisionit në pranimin e kalendarit të ndryshëm për likuidimin e kësaj të parë të apartamentit, duke vendosur pagesat sipas pretendimit të subjektit të potencuar për herë të parë në nëntor 2023 ose 32 muaj pasi kishte nisur hetimit administrativ për të. Komisioni ka përmbysur gjithë konstatimet mbi bazë aktesh, duke pranuar pretendimet deklarative të subjektit dhe llogaritur shlyerjen e kësaj të parë prej 10.000 USD në tetor 2001, prej 3.000 USD në maj 2004 dhe 7.000 USD në dhjetor 2003, pasi subjekti ka shlyer pagesat për njësinë objekt analize të kësaj rubrike. Kjo përmbysje dhe qasje e vendimit, në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes për apartamentin⁵⁰ dhe deklaratimet e tij të mëparshme, për të favorizuar subjektin për hendekun e qartë mes të ardhurave dhe investimeve të tij në pasuri të paluajtshme, në kushtet që subjekti e familja e tij jetonin *vetëm* me rrogën e tij të prokurorit, prej mesatarisht 750.000 lekë në vit [ekuivalenti i 5.240 eurove ose 6.800 USD në vit], ka passjellë si rezultat balancën negative të reduktuar në mënyrë të konsiderueshme qoftë për krijimin e kësaj pasurie apo edhe apartamentin⁵¹. Në këtë linjë, edhe përfshirja e një vlere të titulluar në analizë si *tepricë e mbartur nga periudha e mëparshme*, në vlerën 591.106 lekë, është një kategori e pakuptimtë dhe e pambështetur në akte të kohës. Në këtë logjikë, nga ushtrimi i kryer në Kolegj, nën dritën e ligjit dhe jurisprudencës së tij, balanca negative për blerjen e pasurisë në fjalë, njësisë me sipërfaqe 40 m², do të rezultonte në shumën (-) 1.473.681 lekë, aq sa është referuar nga Komisioni në rezultatet e hetimit.

12.10. *Së fundmi*, konstatimi i Komisionit se subjekti ka kryer deklaram në kundërshtim me ligjin nr. 9049/2003, ndonëse mund të jetë i saktë, është pa peshë në procesin e rivlerësimit. Në kushtet që objekt kontrolli/analize në kuadër të procesit të rivlerësimit, janë deklaratimet në deklaratën *vetting*, si dhe që mungesa e deklaramit në deklaratën e parë të vitit 2003 është shëruar në deklaratën periodike të vitit 2004, kur subjekti rezultoi ta ketë deklaruar saktësisht këtë pasuri, trajtimi i mëtejshëm i këtij aspekti është i panevojshëm. Në këto kushte, konstatimi i Komisionit për deklaram të pasaktë, sipas ligjit nr. 9049/2003, nuk është i drejtë, pasi i përket një kuadri tjetër

⁵⁰ Në kontratën e sipërmarrjes së datës 6.1.2003, ndër të tjera, është shënuar si kusht penal edhe se për çdo muaj vonesë nga data e dorëzimit të objektit më 31.01.2004, sipërmarrësi i paguan porositësit 100 USD. Për këtë parashikim, sipërmarrësi nuk është shprehur, e as subjekti nuk deklaroi nëse u zbatua apo jo, meqenëse akoma nuk kaloi pronësia.

⁵¹ Sikurse sipër referuar, balanca negative fillestare prej (-) 1.351.420 lekësh është reduktuar në (-) 637.816 lekë dhe balanca negative për këtë pasuri, është reduktuar nga (-) 1.473.681 lekë në (-) 882.576 lekë, përpos përmbysjes së balancës negative për kursimet e deklaruara si shtesa etj.

ligjor, të ndryshëm nga ai i rivlerësimit, analizuar në kuadër të pretendimeve me natyrë procedurale, si një vlerësim i tillë që nuk ka peshë në vendimmarrjen e Komisionit.

13. Të ardhurat nga shitja e automjetit tip “Mercedes Benz”, prodhim i vitit 1991

13.1. Kjo pasuri e analizuar në vendimin e Komisionit nuk ishte pasuri ekzistuese në momentin e plotësimit të deklaratës *vetting*. Komisioni e analizoi atë në kuadër të analizës së viteve 2005 dhe 2009, në të cilat subjekti rezultoi me një balancë negative, me efekt në periudhën e rivlerësimit. Konkretisht, subjekti ka pretenduar se ka blerë automjetin në vitin 2005 kundrejt çmimit 400.000 lekë dhe shitur atë në janar 2009 kundrejt çmimit 4.800 euro. Në deklaratën për vitin 2005, subjekti ka referuar të ardhurat nga paga si burim krijimi, ndërsa gjatë hetimit administrativ, pasi është njohur me rezultatet e hetimit, subjekti ka pretenduar se ka marrë hua nga prindërit e bashkëshortes për të blerë këtë pasuri. Komisioni ka analizuar mundësinë financiare të blerjes në vitin 2005, ndërsa në analizën financiare për vitin 2009 ka përllogaritur të ardhurat nga shitja sa vlera e blerjes, duke e gjetur jobindës përfitimin e një vlerë shitjeje më të lartë sesa ajo e blerjes për shkak të amortizimit. Përfundimisht, Komisioni konkludoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin burimin e krijimit të kësaj pasurie dhe ka mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin e saj, për shkak të një balance negative prej (-) 400.000 lekësh, duke u gjendur në kushtet e germës “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

13.2. Subjekti kundërshton qëndrimin e Komisionit, që sipas tij është në kundërshtim me praktikën e Kolegjit. Sipas tij, për sa kohë Komisioni nuk ngriti dyshime rreth fiktivitetit të kontratës së shitjes, vlerat duhet të përfshiheshin sipas kontratave respektive. Gjithashtu, subjekti pretendon se në deklaratën periodike të vitit 2005 deklaroi *burimin fundor* të krijimit të të ardhurave që shërbyen për blerjen e automjetit, që ishin të ardhurat nga paga. Duke qenë se gjatë vitit 2004 jetoi me prindërit e bashkëshortes në datën 04.01.2005 u mori atyre shumën që nevojitej për të blerë automjetin dhe ua ktheu brenda vitit me të ardhurat nga pagat, e që nuk kishte detyrim deklarimi⁵².

13.3. Nga kontrolli i analizës financiare të Komisionit, trupi gjykues i Kolegjit e gjen të bazuar konstatimin se subjekti ka mungesë burimesh të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie në vitin 2005, sikurse edhe rritja e vlerës në shitje rezulton *pa logjikë* ekonomike. Pretendimet e subjektit u vlerësuan të pabazuara. Trupi gjykues i Kolegjit çmon të theksojë që edhe për këtë pasuri Komisioni është treguar kontradiktor, duke përllogaritur edhe vlerën origjinale prej 400.000 lekësh në momentin e shitjes, ndonëse subjekti ka rezultuar me mungesë burimesh për krijimin e kësaj pasurie që në atë moment. Për pasojë, nën dritën e garancive procedurale me ankimin, edhe në analizën e kryer në Kolegj u konfirmua *më së paku* mungesa e burimeve të ligjshme që passjell ky konstatim për analizën financiare të subjektit për vitin 2009.

13.4. Qëndrimi i Komisionit për të mospërfshirë vlerën e referuar në kontratën e shitjes është i drejtë. Në kushtet që rritja e vlerës së këtij automjeti, mbeti deklarative nga njëra anë, dhe të logjikës së thjeshtë ekonomike për amortizimin e pasurive të luajtshme, nga ana tjetër, nëpërmjet

⁵² Subjekti referon vendimet e Kolegjit: (JR) nr. 31/2020 që i përket subjektit të rivlerësimit Elvin Gokaj; (JR) nr. 26/2023 që i përket subjektit të rivlerësimit Gentiana Xhelili dhe (JR) nr. 41/2022 që i përket subjektit të rivlerësimit Eda Kaja.

investimeve të kryera nga subjekti në katër (4) vitet që ai e përdori, dhe shitjes me fitim në vitin 2009 – pas 18 vjetësh nga prodhimi i këtij automjeti, sikurse trajtuar gjerësisht në jurisprudencën e Kolegjit, pretendimet e subjektit duhet të ishin analizuar kundrejt kontekstit të shpenzimeve të kryera prej tij për mirëmbajtjen apo veprimeve të tjera financiare gjatë vitit 2009, për t'i dhënë cilësimin e saktë ligjor. Analiza mbi të cilën bazohet ky konkluzion shtjellohet në vijim.

13.5. Nga aktet rezulton se pasi ka përdorur katër (4) vite këtë automjet, të blerë kundrejt çmimit 400.000 lekë në datën 04.01.2005, subjekti e ka shitur atë kundrejt vlerës prej thajse 600.000 lekësh, që është ekuivalenti i çmimit të kontratës prej 4.800 eurosh, sipas kursit të këmbimit në janar 2005⁵³. Komisioni i kërkoi subjektit shpjegime me pyetësin nr. 1 për këtë diferencë çmimesh. Subjekti ka pretenduar se çmimi i blerjes ka qenë shumë i favorshëm, ndërsa ai i shitjes pasqyron vlerën e tregut, për shkak edhe të mirëmbajtjes së automjetit. Po ashtu, duke konstatuar se subjekti nuk ka deklaruar kursime *cash* në fund të vitit 2004, të cilat mund të ishin përdorur për blerjen, dhe pasi nga llogaritë bankare, tërheqja e vetme për periudhën 01.01.2005 – 04.01.2005 është kryer më 05.01.2005, në shumën 40.000 lekë, [pas blerjes së automjetit], Komisioni kërkoi shpjegime nga subjekti. Në përfundim të hetimit, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës, pasi rezultoi se subjekti dhe personat e lidhur me të nuk kanë pasur burime të ligjshme financiare për të blerë automjetin me vlerë 400.000 lekë në datën e nënshkrimit të kontratës.

13.6. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar gjithë argumentimin e Komisionit, duke specifikuar se automjeti në fjalë nuk përbën objekt të procesit të rivlerësimit, pasi nuk ka qenë në pronësi apo përdorim në momentin e dorëzimit të deklaratës *vetting*. Ai ka pretenduar se Komisioni nuk ka kërkuar shpjegime për këtë pasuri dhe se blerja e saj është bërë me kursimet e prindërve të bashkëshortes, të cilat ua ktheu gjatë vitit 2005. Nuk ka pasur dokumentacion për shkak të raportit të afërt familjar. Subjekti ka kërkuar që analiza financiare të shtrihet përtej të ardhurave të tij dhe të përfshijë edhe ato të prindërve të bashkëshortes.

13.7. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se Komisioni edhe në këtë aspekt të kontrollit ka ushtruar qasjen e tij tejet favorizuese. Ky vlerësim mban në konsideratë që ndonëse shprehet për mungesë logjike ekonomike në blerjen lirë dhe shitjen shtrenjtë, sidomos të një automjeti që ishte prodhim i 18 vjetëve më herët me vlerë 50%⁵⁴ më të lartë se ajo e blerjes apo faktit që subjekti qartazi *nuk* kishte burime të ligjshme për ta blerë këtë pasuri në janar 2004, Komisioni nuk i jep cilësimin e duhur situatës ligjore dhe as nuk e përkthen në terma financiarë këtë konstatim. Konkretisht, përpara veprimeve fiktive të kryera për efekt të krijimit të gjendjes financiare/likuiditeteve në momentin e shitjes apo çmim fiktiv në momentin e blerjes për të anashkaluar mungesën e burimeve në momentin e krijimit, Komisioni kufizohet vetëm duke referuar pa konkluzion mungesën e logjikës ekonomike dhe përfshirjen gjithsesi të shumës së shpenzuar për blerjen e automjetit, ndonëse qartazi subjekti nuk ka pasur burime të ligjshme për ta blerë atë më 04.01.2005 me të ardhurat nga paga, të cilat nuk janë prekur deri një ditë pas blerjes së kësaj pasurie dhe në 1/10 e vlerës së saj gjithsesi.

⁵³ Sipas kursit të këmbimit në datën 20.1.2009, 1 euro = 124,98 lekë.

⁵⁴ 49.9 %, për të qenë më konkret.

13.8. Një analizë rigoroze nuk mund të mos kishte orientuar konstatimin gjatë hetimit në Komision drejt nevojës së spikatur që kishte subjekti për të krijuar panoramën e fondeve të lira për efekt të krijimit të pasurisë tjetër, automjetit “Mercedes-Benz”, të blerë në shkurt 2009, tashmë në shumën 9.500 euro. Ky i fundit deklarohet i krijuar nga shitja e automjetit tjetër [4.800 euro] dhe kursimet. Po ashtu, gjatë vitit 2009, subjekti ka shlyer para kohe një kredi bankare në shumën 20.000 euro. Këto veprime me ndikim të ndjeshëm në analizën financiare të vitit, që duhet të kenë diktuar në një moment të mëpasmë edhe depozitimin e “Deklaratës sqaruese”, pa datë të tij, sikurse edhe asaj të vitit 2012, janë pjesë integrale e aspekteve të ndryshme, të cilat Komisioni nuk rezulton t’i ketë dhënë peshën e duhur. Përpos këtyre aspekteve, rezulton që për automjetin e blerë në shkurt 2009, Komisioni ka përfshirë në mesin e burimeve të ligjshme të disponuara edhe të ardhurat e pjesës tjetër të vitit, për nëntë (9) muajt në vijim, që nënkupton që për këtë pasuri nuk ka një analizë të kryer për momentin e krijimit të saj. Ky konstatim paraqitet në linjën e aspekteve për të cilat Kolegji vëren favorizim nga Komisioni. Efekti financiar i tij nuk u pasqyrua në analizën e kryer në Kolegj për efekt të zgjidhjes përfundimtare, për shkak të garancive procedurale me ankimin.

13.9. Nga ana tjetër, pretendimi i ardhur rishtazi, pas kalimit të barrës së provës, për ndihmesë edhe në këtë rast nga prindërit e bashkëshortes, është qëndrim i bazuar. Përpos faktit që huamarrja nga vjehëria e subjektit paraqitet në një fazë të avancuar dhe, për pasojë, e pabesueshme, trupi gjykues i Kolegjit thekson se subjekti, po ashtu, nuk ka sjellë asnjë dokumentacion qoftë edhe rrethanor apo indicie të kohës që të tregonte këtë nevojë kritike e të ngutshme të tij për të marrë hua te prindërit e bashkëshortes. Sikurse referuar më sipër, në këtë periudhë kohore, vetëm të ardhurat e bashkëshortes nga avokatia deklarohen në shumën 2.000.000 lekë, përpos të ardhurave të subjektit. Duke abstraguuar edhe nga fakti që subjekti nuk ka sjellë as deklaratën e prindërve të bashkëshortes që të konfirmojë ekzistencën e marrëdhënies së huas, sipas pikës 4 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016⁵⁵, dhe përjashtuar kështu mundësinë e kryerjes së një analize financiare të tyre, trupi gjykues i Kolegjit e analizoi edhe këtë aspekt në tërësinë e elementeve të tjerë për të cilët subjekti rezulton i pabesueshëm dhe me zigzage deklarimesh për efekt të nevojës momentale.

13.10. Përprjekjet e subjektit për të modifikuar burimet, në përputhje me nevojat e subjektit për uljen e rezultatit negativ financiar të rezultateve të hetimit, jo vetëm për këtë pasuri, por edhe për apartamentin 70 m², u analizua në drejtim të serisë së mungesës së koherencës e sinqeritetit prej tij, si përprjekje për të përshtatur deklaratimet me nevojën e fazës procedurale dhe jo si pasqyrim i së vërtetës. Si i tillë, edhe ky aspekt u mbaj në konsideratë në drejtim të mungesës së besueshmërisë së subjektit.

13.11. Në përputhje me jurisprudencën e Kolegjit⁵⁶, në kushtet që për vitin 2005 subjekti u gjend me mungesë të burimeve të ligjshme, përpos fiktivitetit të veprimeve të kryera, subjekti do të gjendej në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie, më së paku në vlerën 400.000 lekë në vitin 2005. Nga ana tjetër, për shkak të garancive procedurale me ankimin,

⁵⁵ 4. Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të ose persona të tjerë të lidhur, të deklaruar në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, nëse konfirmojnë këto marrëdhënie, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive.

⁵⁶ Shih, ndër të tjerë, vendimin e Kolegjit (JR) nr. 54/2023, që i përket subjektit të rivlerësimit Kolë Hysenaj, pg 21.7, në: https://kpa.al/wp-content/uploads/2024/03/Vendim-i-anonimizur-JR-Kol%C3%AB-Hysenaj_perfshire-mendimin-parallel.pdf

në balancën negative totale të Komisionit, as në Kolegj, nuk gjeti pasqyrim efekti financiar i balancës negative të vitit 2005 në vitin 2009, pavarësisht se shuma 400.000 lekë është qartazi e ardhur e paligjshme. Nga kontrolli i analizës financiare të vitit 2009, në Kolegj, subjekti rezultoi me një balancë negative në masën (-) 4.101.225 lekë, përkundrajt (-) 901.225 lekë, të konstatuar nga Komisioni. Kjo nënkupton që kjo balancë e fundit konfirmohet gjithsesi edhe në Kolegj.

13.12. Nga ana tjetër, trupi gjykues i Kolegjit, nënvizon edhe se konkluzioni i Komisionit për këtë pasuri [paragrafi 11.1.13, faqe 64-65 e vendimit] se subjekti nuk ka deklaruar saktë e në përputhje me ligjin dhe ka mungesë të burimeve, sipas germës “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, është i pasaktë për pjesën e deklarimit. Kjo pasuri nuk ishte objekt i deklarimit në deklaratën *vetting*, pasi ishte shitur në vitin 2009 dhe, si e tillë, nuk mund të ngarkojë me përgjegjësi deklarimi të saktë subjektin, aq më tepër, që në gjithë deklaratën *vetting*, subjekti nuk i deklaroi të ardhurat nga shitja e tij si burim të krijimit të ndonjë pasurie e për sa kohë nuk e paraqiti këtë situatë, nuk mund t’i ngarkohet përgjegjësi. Nëse me këtë konstatim Komisioni ka pasur qëllim t’i japë një cilësim ligjor problematikës së fiktivitetit – ose mungesës së logjikës ekonomike që pasqyrojnë veprimet e kryera për këtë automjet – përfshirja e saj si pasaktësi në deklaratën *vetting* është e pakuptimtë.

13.13. Për sa më lart, pretendimi i subjektit për të përfshirë në analizë diferencën midis çmimit të shitjes me atë të blerjes nuk qëndron për arsyt e analizuara më lart dhe balanca negative e analizës financiare në Kolegj do të reflektojë më së paku balancën e konstatuar nga Komisioni për vitet 2005 dhe 2009 lidhur me këto të ardhura.

14. *Analiza financiare*

14.1. Balanca negative e konstatuar nga Komisioni, në vendim, krahasuar me rezultatet e hetimit është përmirësuar në mënyrë të spikatur, nëse mbahen në konsideratë rrethanat konkrete ligjore e faktike. Në vendim, Komisioni ka paraqitur si vite me balancë negative periudhën 1998 – 2003 në vlerën (-) 1.392.426 lekë, viti 2004, në vlerën (-) 127.966 lekë, viti 2005 për pamundësinë e blerjes së automjetit, (-) 400.000 lekë, vitin 2009, në vlerën (-) 901.225 lekë. Në total, Komisioni ka mbërritur me një balancë negative prej (-) 2.821.616 lekësh, përkundrajt balancës prej rreth (-) 12.702.941 lekësh të njoftuar subjektit të rivlerësimit në rezultatet e hetimit.

14.2. Subjekti pretendon se balanca e tij totale negative duhet të jetë (-) 577.030 lekë dhe të trajtohet në kuadër të proporcionalitetit. Kjo vlerë, sipas tij, është shumatorja e një balance kumulative negative deri në vitin 2003, prej (-) 449.064 lekësh, një balance negative prej (-) 127.966 lekësh, e cila i atribuohet tërësisht diferencës së kursit të këmbimit të këstit 16.000 USD. Balanca negative e vitit 2003 është për këstin 7.000 euro, të paguar për blerjen e apartamentit me sipërfaqe 70 m², vjen për shkak se në analizën financiare nuk janë përfshirë të ardhurat e bashkëshortes si asistent avokate përgjatë periudhës 1999-2002. Ndërsa pamundësia në vitin 2004, për shlyerjen e shumës 8.000 euro dhe përbalimin e shpenzimeve të jetesës, është krijuar për shkak të diferencës së kursit të këmbimit. Subjekti kundërshton në tërësi balancën negative të vitit 2009, e cila, sipas pretendimit të tij, është pasojë e përfshirjes së shumës 1.600.000 lekë që ai ka deklaruar, por që në fakt i përket “kursimeve të prindërve” të bashkëshortes, referuar atij gabim. Përpos këtyre argumenteve, subjekti kërkon që të përfshihen të ardhurat e bashkëshortes nga puna

si asistente avokate në periudhën përpara vitit 2002 (1999–2002), të ardhurat nga emigracioni, ndihma e familjes së bashkëshortes, dhe të ardhura të tjera që sipas tij janë të justifikuar.

14.3. Trupi gjykues i Kolegjit thekson se sikurse është referuar në mënyrë të përsëritur më sipër, balanca negative e konstatuar nga Komisioni në vlerën prej (-) 2.821.616 lekësh, konfirmohet më së paku edhe në analizën e kryer në Kolegj. Trupi gjykues çmon të theksojë se nëse analiza do të ndiqte logjikën e shprehur të normativës kushtetuese e ligjore, balanca negative me të cilën konstatohet kontrolli i kriterit të pasurisë së subjektit do të ishte shumë më e thellë. Po ashtu, në kushtet që deklarimet e subjektit janë thellësisht inkohente dhe të ndryshuara në mënyrë të qëndrueshme, trupi gjykues i Kolegjit konstaton që subjekti i rivlerësimit nuk është i besueshëm në vlerësimin e kriterit të pasurisë.

14.4. Konkretisht, një analizë e kryer në Kolegj, për të qartësuar e shteruar të gjitha shkaqet e ankimit, rezulton me një balancë negative të përafërt ndonëse pak më të ulët sesa ajo e konstatuar në Komision në rezultatet e hetimit. Konkretisht, balanca në Kolegj do të ishte (-) 12.143.162 lekë, për shpenzimet dhe kursimet e investimet, shpërndarë në më së paku nëntë vite. Pavarësisht nga ky konstatim, për shkak të garancive procedurale me ankimin, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se edhe balanca negative me të cilën ka konkluduar Komisioni, duke qenë tejet garantiste, e rezultat i pranimit të pjesës dërrmuese të pretendimeve deklarative të subjektit, e bën të qartë përse masa disiplinore e shkarkimit është e drejtë, objektive dhe përtej çdo kontestimi proporcional me situatën e mungesës së theksuar të besueshmërisë, koherencës e transparencës së subjektit.

14.5. Në analizën e Komisionit ka disa aspekte të tjera, të cilat paraqiten në vijim si *obiter dictum*, si nevojë për të shteruar të gjithë situatën që rezulton nga aktet, ndonëse për to nuk ka asnjë pasojë për subjektin në Komision e në Kolegj. Konkretisht, Komisioni:

(i) ka përfshirë në analizën financiare si të ardhura të ligjshme, të ardhura nga qiraja, për të cilat tatimi është paguar, pasi subjekti është njohur me rezultatet e hetimit administrativ në Komision, që ka ndodhur në shkurt 2024, dy muaj përpara vendimit objekt ankimi;

(ii) përfshirë si të ardhura nga *aktiviteti* i bashkëshortes 4.000.000 lekë, të cilat janë pasqyruar në akte si hua dhe tërheqje nga arka e kompanisë në vitet 2014 dhe 2016, e marrë prej saj nga personi juridik në emër të saj dhe administruar nga e ëma. Këto të ardhura nuk janë deklaruar në deklaratat periodike apo *vetting* në mesin e të ardhurave të përdorura apo ruajtura për qëllime private. Dokumentacioni provues është depozituar gjatë hetimit në funksion të analizës financiare, nuk është akt i dokumentuar i kohës, pasi janë dokumente të thjeshta të hartuara nga dy persona shumë të afërt, në cilësitë përkatëse që ato kanë në personin juridik pronë e bashkëshortes së subjektit;

(iii) Komisioni ka anashkaluar problematika të besueshmërisë së subjektit edhe për sa i përket krijimit të një sasive të ardhurash prej 200% të vlerës së shpenzuar për pjesën takuese në vitin 2014 nëpërmjet transaksioneve që lidhen me apartamentin në Durrës⁵⁷, shitur prej tij e bashkëshortes [në pjesën takuese] prindërve të saj. Komisioni duket se ka anashkaluar dhënien e një përgjigjeje objektive për marrëdhënien e vërtetë të subjektit me këtë pasuri, ndonëse subjekti e ka adresën e deklaruar në Gjendje Civile dhe adresë banimi këtë apartament, deri në deklaratën *vetting*, ndonëse

⁵⁷ Referuar edhe më sipër në poshtëshënimin nr. 24.

i ishte shitur me fitim të konsiderueshëm prindërve të bashkëshortes që në vitin 2014 apo që burimi i deklaruar i krijimit [kredia] është lëvruar dy javë pas blerjes, problematika e mungesës së burimeve të ligjshme për shlyerjen e parakohshme të kredisë në qershor 2009 dhe investimeve e kursimeve të tjera apo që subjekti dhe familja e tij jetonin me prindërit e bashkëshortes në kohën e kryerjes së depozitimeve bankare, që kanë shërbyer si burim për pagesën e çmimit të apartamentit dhe, *së fundmi*, që prindërit e bashkëshortes nuk justifikojnë plotësisht me të ardhura të ligjshme blerjen e këtij apartamenti, krijimin e depozitave dhe kryerjen e shpenzimeve për periudhën 1994 – shtator 2014.

15. Në përfundim, në analizë të shkaqeve të ankimit dhe nën dritën e përcaktimeve të pikës 1 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe të germës “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vlerësoi se subjekti i rivlerësimit është në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për të krijimin e pasurive dhe përballimin e shpenzimeve, të cilat për shkak të gjithë rrethanave të analizuara në detaj me sipër, përbëjnë deklaram të pasaktë e të pamjaftueshëm, parashikuar nga pika 3 e nenit 61 të ligjit nr. 84/2016. Për këto arsye, vendimi nr. 758, datë 16.04.2024, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që ka shkarkuar nga detyra subjektin e rivlerësimit, është i mbështetur në prova e në ligj dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues i Kolegjit, bazuar në nenin 66, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 758, datë 16.04.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Madrid Kullolli.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall në Tiranë, sot më datë 18.12.2025.

ANËTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

ANËTARE

Mimoza TASI

nënshkrimi

ANËTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

RELATORE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

KRYESUESE

Ina RAMA

nënshkrimi